



PËRSE I JANË MIRËNJOHËS HISTORIA KOMBËTARE DHE POPULLI SHQIPTAR ENVER HOXHËS

Referat i shokut Hysni Millosi, Kryetar i Partisë Komuniste të Shqipërisë, mbajtur në Konferencën Kombëtare kushtuar 100 vjetorit të ditëlindjes së Enver Hoxhës.

Shokë dhe shoqe,
Të dashur miq!
I nderuar përfaqësues i familjes së Enver Hoxhës!

Që nga lashtësia Eskiliane e deri më sot historia ka provuar gjithëmonë se: Fjalët e së vërtetës janë të thjeshta.

Sot mbushen plot 100 vjet nga dita kur lindi Enver Hoxha. E vërteta historike rreth kësaj figure të madhe kombëtare është e thjeshtë për atë që dëshiron ta kuptojë. Aq sa është e vërtetë se ky bir i popullit vetë jetën e tij e konceptoi si një detyrë ndaj Atdheut e që duhej ta kthente në shërbim të tij, aq e vërtetë është se pikërisht koha në të cilin jetoi, mori emrin e tij.

Epoka që mban emrin e Enver Hoxhës është epoka e njeriut që luftoi e punoi për popullin e jo vetëm për vete. **Nëqoftëse njeriu punon vetëm për vete, thoshte Karl Marksi, ai mundet, ndoshta, të bëhet shkencëtar i dëgjuar, filozof i madh, poet i shkëlqyer, por kurrë nuk do të jetë njeri me të vërtetë i përkryer dhe i madh.**

Është një e vërtetë shumë e thjeshtë se Enver Hoxha mishëroi Shqipërinë dhe në personalitetin e tij ka shkëlqyer e do të shkëlqejë njeriu i përkryer e i madh, që, ashtu si Skënderbeu e Naim Frashëri për kohën e tyre, mbetet një pikë referimi për kohën tonë e të ardhmen.

Edhe fjalët e kësaj të vërtete janë fare të thjeshta dhe s'ka shumë nevojë që emëri i Enver Hoxhës të mbulohet me kurora fjalësh të mëdha, sepse nën këto kurora, po të flasim sipas gjykimit të Vladimir Majakovskit në poemën kushtuar Leninit, mund të zbehej sadopak e vërteta. Jeta e gjallë njerëzore, brezat e rinj që do të vijnë s'kanë nevojë për një të vërtetë të zbehtë mbuluar me kurora fjalësh pa jetë por për një të vërtetë që të shkëlqejë si rrezet e Diellit.

Kur lindi si sot e 100 vjet më parë e kur pagëzohej me emërin Enver, askush nuk mund ta dinte se koha e ardhshme do të mbante emërin e tij. Shumëkujt mund t'i ngjante kalaja e Gjirokastrës si një kryqëzor i madh në mjergullën e kohës, por askujt nuk mund t'i shkonte në mendje se ai djalë i sapolindur do të drejtonte në vitet që vinin me trimëri e guxim, vizion e besim, vullnet e aftësi legjendar kryqëzorin e kohës dhe se do të ë hynte në histori si shpëtimtar i Atdheut dhe i kombit të vet.

Kur lindi Enveri jeta në Shqipëri nuk kishte ndonjë ndryshim të madh me atë që bënin të burgosurit në bodrumet e kalasë së Gjirokastrës. Fati i kombit tonë ndodhej në udhëkryq e mjergull të zezë si nata e ferrit. Edhe pse vetëm katër vjet më pas patrioti i madh Ismail Qemali, tok me Luigi Gurakuqin e Shkodrës, Isa Boletinin e Mitrovicës së Kosovës e perkursorë të tjerë të mëdhenj, që përfaqësonin gjithë kombin, shpalosi në Vlorë Flamurin Kombëtar dhe e shpalli Shqipërinë të lirë e të mosvarme, Shqipëria nuk u bë dot as e lirë, as e mosvarme, prandaj dhe njëri nga intelektualët tanë më të mëdhenj të të gjitha kohërave, ish kryeministri i Shqipërisë, Fan Noli, do të shprehej pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore se ndoshta historianët kur të flisnin për liri e pavarësi të vërtetë të Shqipërisë do të shënonin pikërisht 29 Nëntorin

e vitit 1944 kur në pushtet erdhi guvernata e Enver Hoxhës. Ai kishte parasysh të vërtetat historike që kishin qenë tragjike.

Shqipëria nuk e gëzoi as pavarësinë, as integritetin tokësor, sepse nga trangu i Atdheut të shqiptarëve do të pritej me sopatën e fuqive të mëdha imperialiste të Evropës më shumë se gjysma e tokave të kombit shqiptar e do t'u falej fuqive shoviniste të Ballkanit. Ndërkaq brenda Shqipërisë se mbetur, kur do të sundonin herë princ Vidi, herë austro-hungarezët, herë francezët e herë italianët, me shtypjen e revolucionit demokratiko-borgjez 1924 dhe rënien e qeverisë së Nolit, shtyllat më të arta të kombit tonë do të binin me gjëmë tronditëse një nga një nga plumbat e tradhëtarëve zogistë.

Enver Hoxha, i kthyer nga Evropa, ose më saktë nga Franca e iluministëve e revolucionarëve të mëdhenj, nga Franca e Komunes së Parisit, nga Franca e komunistëve të Marsel Kashenit e Gabriel Perisë, e kuptonte fare qartë se Bastija e Parisit, "Varri i kombit", siç e kishin quajtur francezët Bastijen, ishte ende gjallë në Tiranë. Ka qenë viti 1936 kur djaloshi 28 vjeçar Enver Hoxha do të betohej në emër të djalërisë shqiptare para varrit të njërit prej këtyre shtyllave të arta: Bajo Topullit.

Fjalimi i Enver Hoxhës në Gjirokastrë ishte një nga sinjalet shpresëdhënëse se edhe në Shqipëri Bastijës do t'i vinte një ditë fundi. Koha që nga kjo orë betimi i vitit 1936 e deri më 11 Prill 1985 do të hynte në histori në fakt si koha heroike e Enver Hoxhës dhe partizanëve të tij. Kjo kohë 50 vjeçare do të ngrihej në historikun e kombit tonë si një monument i jashtëzakonshëm e i madhërishëm, ku dy – tre breza të tërë kishin derdhur gjakun dhe djersën, tërë floririn e energjive mendore e fizike, patriotike e atdhetare, punëtore e komuniste.

Por me afrimin e viteve 90-të të shekullit një forcë satanike do të rrezikonte për vdekje këtë monument të shenjtë: **Tradhëtia e lartë** e shtabit udhëheqës të Partisë të Punës së Shqipërisë, e cila do të shënonte **tradhëtinë më të madhe në historinë mijërvjeçare të Shqipërisë**. Ne pamë se si koha mbarsur me tradhëti kishte qenë shtatzënë e polli shumë Esat Pashë Toptanë. Një satanizëm i llahtarshëm, i pabesë, do të vërshonte rrugëve të Tiranës inkuadruar në turma të verbëra të lumpenproletariatit e pinjollëve kolaboracionistë e reaksionarë me damkë, duke tundur flamurin e zi të kundërrevolucionit, të cilin mjerisht e mbanin në duar e në ballë të tyre disa komunistë renegatë, të privilegjuar, sharlatanë e makiavelistë, obskurantistë e terroristë. Ky satanizëm i paimagjinueshëm që doli befasisht dhe jo befasisht nga shpellat e tradhëtisë do të ndërmerre një kryqëzatë inkuizicioniste të pashembullt kundër figurës epokale të Enver Hoxhës në veçanti.

Po bëhen gati dy dekada që ofensiva satanike e kundërrevolucionit ka sulmuar me të gjitha armët e arsenalit propagandistik e shtetëror për të varrosur e rishkruar një histori rreth 50 vjeçare, gjithmonë në përpjekje të zellshme e të papërmbajtur për ta kriminalizuar atë dhe veprën e Enver Hoxhës që është e lidhur pazgjidhmërisht me një gjysëm shekulli. Vandalizmi i organizuar shtetëror kundër socializmit e komunizmit, ngjarjeve e monumenteve të historisë sonë kombëtare nisi me simbolet e Enver Hoxhës, vijoi pastaj me simbolet e heronjve antifashistë e po vijon edhe sot e kësaj dite deri kundër emërit të Ismail Qemalit apo 5 Heronjve të Vigut, monumentin madhështor të të cilëve Bashkia reaksionare e Shkodrës ka vendosur ta shkulë prej vendit të merituar ku e vendosi historia.

"Bastija" e ditëve tona nuk është më pak kriminale se Bastia e dikurshme e Luigjëve të Francës. Kryeministrat që kanë ardhur në pushtet me kabinetet e tyre, edhe pse disa kanë qenë ish komunistë ose bij komunistësh, mund të portretizohen saktësisht vetëm me dy fjalë: **Armiq të Popullit**. Tragjeditë që ka pësuar populli në këto vite kanë qenë të paimagjinueshme. Disa prej tyre, si ai i vitit 1997, s'kanë shokuar vetëm popullin tonë, por gjithë Botën. **Fantazmat kurrizthyerë të Botës së Vjetër janë**

zgjuar e kërkojnë të përmbysët toka në emër të persekutorëve politikë. Nuk jini të persekutuar politikë, zotërinj, po tradhëtarë e bij tradhëtarësh, pinjollë kolaboracionistësh e kriminelësh. Nesë jeni gjallë, kjo për hir të humanizmit komunist.

Në këtë situatë politike antipopullore e antikombëtare e përkujton sot Partia Komuniste e Shqipërisë jubileun e ndritur të 100 vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës nëpërmjet kësaj konference me të vërtetë kombëtare, ku marrin pjesë përfaqësues nga e gjithë Shqipëria dhe nga e gjithë Kosova.

Konferencën tonë jubilarë e nderojnë dhe shokë e miq të huaj, si shoku Giorgos Havatzas nga Partia Komuniste e Greqisë, shoku Raul Marko nga Partia Komuniste Spanjolle, shoku Vim Kenis nga Partia e Punës e Belgjikës, shoku Bruno Morand nga Grupi Komunist i Francës, shoku Mauricio Nocera nga Partia e Komunistëve Italianë, shoku Osman nga Partia Komuniste Revolucionare e Turqisë, shoku Mehmet Ozer nga Partia e Punëtorëve e Turqisë, shokë nga Partitë Komuniste të Brazilit, si dhe gazetarë nga Danimarka e Tunizia, të cilëve KQ i PKSHE u shpreh mirënjohjen më të sinqertë.

Me këtë rast PKSHE ka rastin të deklarojë edhe njëherë solemnisht e botërisht se Epoka 50 vjeçare e Enver Hoxhës ka qenë e do mbetet Epoka e Rilindjes së kombit tonë. Nga kjo tribunë e 100 vjetorit të Enver Hoxhës ne i drejtohem i edhe një herë “Bastijes” kriminale të tradhëtarëve në krye të qeverive të djathta e të majta që erdhën në vitet 90-të si jini ju që do të përgjigjeni në gjyqin e historisë, sepse jeni ju që kini gërmuar e po gërmoni përditë e më thellë varrin e kombit. Por mos harroni: Ju që gërmoni varrin e kombit do të bini vetë brenda.

Ne komunistët as trembemi, as përkulemi përpara padrejtësive e ligjeve të padrejta, por vetëm krenohemi e përkulemi para jetës dhe veprës së Enver Hoxhës, këtij Heroi Kombëtar, pa emrin e të cilit do të ngjante shkretëtirë historia moderne e Shqipërisë. Epoka që ai bëri ishte një mrekulli. **Edhe mrekullitë mund të gjykohen, sepse ashtu si dielli që ka njollat e veta edhe ato nuk bëjnë përjashtim.** Por ashtu sie dielli, edhe mrekullitë e epokave dhe njerëzve si Enver Hoxha vlerësohen për dritën që japin në shërbim të historisë e idealeve më të larta. **Enver Hoxha ishte njeriu i dritës.** Le të ulurijnë sa të duan bandat e reaksionit, populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës për çka ai bëri.

Shokë dhe shoqe,
Të dashur miq!

Ashtu si universi i tërë nuk mund të rrokët nga fokusi i një aparati fotografik, sado i fjalës së fundit të jetës, ashtu dhe universi i jetës dhe veprës së Enver Hoxhës, nuk mund të fokusohen të gjitha në këtë referat që ma besoi ta mbaj në këtë 100 vjetor të lavdishëm Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë, të cilit i jam mirënjohës për nderin e madh e mundësitë që më dha për të evidentuar disa nga meritat në vargmalin e meritave të pakontestueshme që pati ky bir i popullit si revolucionar e komunist i orëve të para, udhëheqës politik e strateg i madh ushtarak, si ideator vizionar e filozof, si diplomat e burrë shteti, si patriot e internacionalist, si arkitekt i një Bote thellësisht të re në një Shqipëri tmerrësisht të prapambetur.

Enver Hoxha është njëri ndër dyqind komunistët shqiptarë që themeluan më 8 Nëntor 1941 Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe **udhëheqësi i saj lavdishëm** deri në sekondat e fundit të jetës. Kur themelohej Partia Komuniste, Enver Hoxha s'kishte ndonjë përvojë si udhëheqës, s'kish qenë shumë herët i anëtarësuar në radhët e grupeve komuniste e për rrjedhojë as kryetar i ndonjë grupi komunist, por kishte bashkëpunuar me grupet, sidomos atë të Korçës, njëjtte si askush tjetër anët pozitive

dhe negative të tyre dhe i përfshirë me tërë energjitë e tij në lëvizjen komuniste dhe rezistencën revolucionare, sidomos që nga 7 Prilli 1939 e këtej, askush më shumë se ai nuk e kuptonte **momentin historik** dhe askush më mirë se ai nuk mund të përcaktonte taktikën dhe strategjinë e Partisë Komuniste në vargun e betejave e të luftës që kishin përpara komunistët shqiptarë.

Inteligjent i rrallë nga natyra, po dhe intelektual me kulturën e duhur kombëtare, qytetare e marksiste, ai më shumë se çdokush tjetër e kuptonte se kjo Parti duhej të ishte një Parti e tipit të ri, marksiste-leniniste, duhej ta zbatonte në përputhje me kushtet konkrete të Shqipërisë së asaj kohe, **të shihte larg, por t'i hidhte me kujdes e në kohën e duhur hapat.**

Enver Hoxha nuk vinte nga stanet e barinjve, as nga vilat e aristokracisë borgjeze, as nga klube akademike intelektualësh llafazanë. Ai vinte në radhët e Partisë e në krye të saj si një intelektual patriot, si komunist revolucionar, partizan i teorisë dhe aksionit, që njihte dhe e dashuronte me zëmer historinë e popullit të vet, por dhe historinë e lëvizjet përparimtare të popujve të Evropës. E njihte mirë komunën e Parisit si shtetin e parë revolucionar të klasës punëtore, me meritat e mëdha e rëndësinë historike, po edhe dobësitë e gabimet e saj. Njihte në shkallën e duhur historinë e Partisë Bolshevike të Leninit dhe të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, historinë e oportunitetit e trockizmit, me pak fjalë edhe komunizmin edhe antikomunizmin.

I ndriçuar nga doktrina marksiste – leniniste e i bindur në këtë doktrinë, Enver Hoxha ishte i vetëdijshëm se pa një Parti të fortë revolucionare nuk mund të sigurohej fitorja e revolucionit, nuk mund të vendosej në të ardhmen **diktatura e proletariatit** e nuk mund të realizoheshin transformimet shoqërore – ekonomike socialiste.

Por nuk ishte e mjaftueshme vetëm t'i dije këto. Puna ishte si do të ndërtohej në praktikë një Parti e tillë, si do të zhvillohej në përputhje konkrete me rrethanat e Shqipërisë, si do të zhvillohej marksizmi në mënyrë krijuese. Momentalisht Enver Hoxha vuri në plan të parë çlirimin kombëtar nga pushtuesit fashistë italianë. **Enver Hoxha, si komunist i tipit Leninist, ishte i bindur se dhe ky çlirim nuk do të mund të realizohej pa një Parti Komuniste të pastër ideologjikisht, politikisht, organizativisht, moralisht, që të vepronte me një disiplinë të lartë leniniste, të çeliktë, unike në fjalë e në vepra, pa grupazhe e fraksione, pa gjarpërinj në gji. Vetëm një Parti e tillë, me autoritet të lartë, e pastër sie kristali dhe e fortë si çeliku, e matur si urtësia dhe e furishme si uragani, e dashur si Nëna dhe e zjarrtë si Dielli, heroike si Skënderbeu dhe e madhërishtme si vetmohimi, mund të tërhiqte si forcë e jashtëzakonshme magnetike rreth saj punëtorët e fshatarët, rininë shkollorë dhe gratë, intelektualët patriotë, gjithë popullin në një ushtri të vetme politike të luftës e barrikadave, betejave e ngadhnjimeve drej Lirisë, drej një Bote të Re pa të shtypur e të shfrytëzuar.**

Falë gjenialitetit të tij, po dhe shokëve të tij komunistë të tipit Qemal Stafa e Gogo Nushi, Vasil Shanto e Vojo Kushi, Hysni Kapo e Abaz Shehu e qindra si këta, Enver Hoxha ia ariti të organizojë një pararojë titanike vetmohuese, e cila ngrohu e ndezi flakë shpirtin e një populli të vuajtur e të etur për liri e pavarësi. **Është një rast unik në historinë e lëvizjes komuniste botërore që një Parti e sapokrijuar dhe vetëm me 200 anëtarë të afirmohej në popull brenda pak muajsh, të udhëhiqte si forcë politike e vetme një revolucion të tërë dhe ta kurorëzonte atë me fitore.**

Një shembull të dytë si shembulli shqiptar nuk njeh historia e lëvizjes komuniste botërore. Kujtoni Partinë Komuniste italiane dhe franceze, dy parti nga më të mëdhatë e me emër shumë të madh e të merituar në Evropë. E para përjetoi kapitullimin e fashizmit, e vari për këmbësh Benito Musolinin, por nuk diti t'i shfrytëzojë rrethanat, popullaritetin dhe besimin dhe, në vend që të varte për

këmbësh borgjezinë e të realizonte çlirimin shoqëror, ishte borgjezia ajo që vari për këmbësh atë. E dyta, gjithashtu partia më e madhe në Francë, e njohur në të gjithë botën për internacionalizmin e saj, sidomos për kontributin historik që ajo dha në ndihmë të Spanjës Republikane, partia e vetme që i rezistoi bishës hitleriane dhe e mbrojti Parisin kur mareshalli Peten e tradhëtonte atë, Partia që i dha luftës aq heronj e heroina, nuk mundi megjithatë që të merrte pushtetin që i takonte, sepse kryetari i saj i drejtohej nga Moska Dë Golit: A mund të kthehem tani në Paris zoti Dë Gol, unë që jam i dënuar me vdekje nga fashizmi? Dë Goli kënaqej nga kjo letër dhe nga pamundësia për të bërë ndryshe e ftonte përkohësisht në pushtet. **Enver Hoxha ishte udhëheqës i tjetër brumi.**

Populli shqiptar besoi në Partinë Komuniste dhe Enver Hoxhën, i cili nuk doli në krye të saj me uratën e Shën Kozmait, po me një veprimtari tepër aktive si anëtar i Komitetit Qëndror provizor të saj e sekretar politik i Tiranës. Populli shqiptar e ndoqi pas Enver Hoxhën në luftë për liri e në punë për ndërtim, në situata të qeta e shumë të rënda, i bashkuar rreth tij si degë rreth lisit. Ndërkaq Enver Hoxha iu përmbajt gjatë gjithë jetës domosdoshmërisë jetike **të rolit udhëheqës të Partisë**. Njeriu i thjeshtë i popullit Partinë e identifikonte me Enverin, i cili hodhi rrënjë të thella në shpirtin e tij, prandaj dhe e ndoqi pas mbi 40 vjet. Dhe ishte gati ta ndiqte rrugën e tij edhe 40 mijë vjet. Por u tradhëtua. Në Kongresin e Dhjetë të Partisë, pikërisht në 50 vjetorin e krijimit, udhëheqja e saj deklaroi se komunistët e kishin kryer misionin e tyre, se tani hapej një faqe e re kapitaliste për të dhe shpalli likuidimin e Partisë 50 vjeçare të Enver Hoxhës.

Kjo deklaratë e ky vendim të kujtonte një pasazh nga vepra e Marksit **“Lufta civile në Francë”** kur flet për Tierin, që i thoshte Republikës, si xhelati Don Karlosit: **”Do të të vras, por për të mirën tënde”**. E për të mos shkuar gjer tek Marksi, mund të afrohem tek historia e komunistit Hamit Shijaku, i pari komunist shqiptar që do të varej në litar nga fashizmi. Trekëmbshi ishte ngritur tre ditë para që të borgosurit të tmerroheshin. Hamit Shijaku shkoi krenar përpara litarit duke kënduar “Internacionalen”.

Në qershor të vitit 1991 po ndodhte një ekzekutim shumë më makabër. Jo në një oborr burgu, por mu në Pallatin e Kongreseve po ekzekutohej një Parti e tërë, ajo për të cilën kishte vdekur duke kënduar Hamit Shijaku e mijëra të tjerë si ai. Partinë Komuniste të Enver Hoxhës, dënuar dikur me vdekje nga fashizmi, nuk po e ekzekutonin fashistët, por vetë udhëheqësit e Partisë, duke i thënë **“Po të vras, por për të mirën tënde”**. Në këtë skenë të llahtarshme nuk u këndua “Internacionalja”, po kënga e tradhëtisë së madhe.

Si do që ndodhi populli dhe historia nuk mund ta harrojnë Partinë Komuniste të Enver Hoxhës. Është thënë e stërthënë, pohuar e stërpohuar një e vërtetë rrëqethëse. Po të mos ishte themeluar Partia Komuniste e po të mos kishte organizuar e udhëhequr luftën, rrethanat ishin të tilla që një popull që kishte humbur lirinë dhe pavarsinë, ishte dënuar të humbiste dhe ekzistencën si komb nëse do të dilte i humbur nga Lufta e Dytë Botërore. Kështu ishin planet e skenaret. Kjo tragjedi nuk ndodhi për meritë të Partisë Komuniste dhe udhëheqësit të saj Enver Hoxha. Nuk u lejua më që fati i Shqipërisë të vendosej nga të huajt. Qoftë dhe vetëm për këtë shpëtim të ekzistencës kombëtare populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha ishte udhëheqësi i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Së pari duhet kujtuar se Enver Hoxha e vuri në vend nderin e Shqipërisë së poshtëruar në orët e zeza të 7 Prillit 1939. Ndërsa fashizmi po zbarkonte në bregdet mbreti dhe oborri i tij butaforik mori udhën e arratisjes e tradhëtisë përtej kufijve të Atdheut. Ushtria mbretërore, me ndonjë përjashtim të vogël, tregoi se kishte qenë një

hiç ushtri, një masë e shpartalluar qysh pa u nisur forcat musoliniane nga Italia. Ishte një poshtërim i Atdheut kur populli kërkoi armë e armë s'i dhanë. Ishte një poshtërim i Atdheut kur ndërsa kapteri Mujo Ulqinaku e bij të popullit vullnetar luftonin e derdhnin gjakun në bregdet, borgjezia vendase mbliidhte lule për fashistët. Ishte një poshtërim akoma më i madh i Atdheut kur përfaqësuesit e borgjezisë shqiptare shkonin si kuadrat ushtarak zvarranikësh në Romë e i dorëzuan Viktor Emanuelit kurorën e Skënderbeut, e firmosën bashkimin e Shqipërisë me Italinë.

Kishin qenë patriotët dhe komunistët që ndezën shkënditë e para të rezistencës. Kishin qenë komunistët e burgosur me në krye Vasil Shanton e Qemal Stafën ata që paralajmëruan 7 Prillin dhe kërkuan të shkonin nga burgu në frontin e luftës qoftë dhe të inkuadruar në batalionet e Ahmet Zogut. Po mbreti tradhëtar, jo vetëm që nuk i liroi, por i siguroi burgun e tyre më fort me xhandarë. Kishte qenë punëtori Vasil Laçi ai që e priti Viktor Emanuelin me plumba. Kishte qenë mbi të gjitha kryerevolucionari Enver Hoxha ai që pas pushtimit fashist la Korçën dhe erdhi në Tiranë, ku që nga dyqani "Flora" vihet faktikisht në krye të rezistencës. Për Enver Hoxhën, që njëherësh tok me Vasil Shanton e Qemal Stafën luftonte për themelimin e Partisë Komuniste, ishin domethënëse këto shkëndi dhe ishte i pari komunist që hyri në lidhje me Myslim Pezën e çetën e tij me besim e optimizëm se nga këto shkëndi do të ndizej një zjarr i madh. Edhe pse ende nuk ishte krijuar Partia, Enver Hoxha shkoi në çetën e Pezës e ngjalli në të optimizëm për fitore. Komandanti i saj, edhe pse një fshatar pa shkollë, e kuptoi komunistin Enver Hoxha, sepse Myslim Peza kishte kryer Universitetin e zgjuarsisë popullore dhe Akademin Ushtarake të rezistencës popullore. **De jure jo, por de facto Enver Hoxha kthehet i pari komisar i të parës çetë partizane në Evropë, asaj të Myslim Pezës.** Më vonë, në krye të Partisë Komuniste, Enver Hoxha ishte organizatori kryesor i njësiteve guerile e çetave të reja partizane, ideatori kryesor i Kryengritjes së Përgjithshme të Armatorsur dhe i bashkimit të popullit në një front të vetëm Antifashist Nacionalçlirimtar.

Në këtë luftë të pabarabartë shkëlqeu personaliteti i Enver Hoxhës edhe si një strateg i madh ushtarak. Si Komisar e Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Partizane ai komandoi e drejtoi si një gjeneral që s'e njohu kurrë disfatën. Nën komandën e tij ushtria partizane e ktheu tokën tonë martire në pëllëmbë e gjak, në pëllëmbë e lavdi. Organizimi prej tij i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë më 10 Korrik 1943, thyerjet e njëpasnjëshme të operacioneve nazifashiste, manovrimi i forcave, ofensivat dhe kundërofensivat që projektoi Enver Hoxha, veçanërisht mësimja pranverore e vitit 1944 përbëjnë njërin ndër kapitujt më të artë të historisë së artit ushtarak shqiptar në shekuj e të Luftës Popullore.

Enver Hoxha ka meritën e rreshtimit të Shqipërisë partizane në frontin e koalicionit antifashist botëror që udhëhiqej nga Stalini, Ruzvelti dhe Çërçilli. Enver Hoxha ka meritën e jashtëzakonshme që ruajti identitetin e luftës partizane dhe e mbështeti çlirimin e Atdheut në gjakun e forcën e popullit, jo nga ushtritë e huaja. Ai ishte i tmerrshëm me armiqtë, por edhe vigjilent me miqtë. Enver Hoxha do të dinte të përballonte presionet jugosllave që bëheshin nëpërmjet Vukmanoviç Tempos, siç diti të përballojë dhe presionet e anglezëve dhe të Shtabit të Mesdheut. Shqipëria partizane ishte vërtetë në frontin e koalicionit të madh, por tre kryetarët e koalicionit i lidhte ideja e mposhtjes së fashizmit, por jo ideja e formave të regjimeve të popujve gjatë kësaj lufte. Në treshen e madhe Stalini ishte Stalini, domethënë violinë e parë. Po edhe presidenti Ruzvelt ishte një personalitet i madh e i arsyeshëm, jo pak i respektuar nga vetë Stalini, ndërsa Çërçilli ishte vetë djalli. Aq sa ishte i detyruar të luftonte në rolin e çlirimtarit të popujve, aq ishte njëherësh edhe një kriminel i popujve. Çërçilli nuk mërzojti që gjakun po e derdhnin komunistët, por synonte që pas çlirimit pushetin ta merrnin kapitalistët. Dhe vetëm për këtë e mbyti

në gjak Athinën në orët kur flamurin e popullit grek po e ngrinin komunistët e lavdishëm grekë. Ai jo vetëm e urdhëroi masakrën e Athinës nga Londra, po i hipi dhe aeroplanit e zbrit në Athinë për të gatuar tragjedinë e madhe të Partisë Komuniste Greke e të popullit grek.

Njihen tashmë presionet që iu bënë Enver Hoxhës nga Shtabi i Mesdheut, njihen synimet e anglezëve për të hyrë në Spile e Sarandë, njihen presionet e tyre që divizionet partizane të mos kalojnë në veri, njihen gjithë intrigat e pabesitë e tyre për ta kthyer Shqipërinë Athinë, por në çdo rast ata u ndeshën me refuzimin kategorik të gjeneralit Enver Hoxha. Askush tjetër nuk mund të dilte triumfator në këtë përballje me rreziqe fatale. Deklarata e ish anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Partizane dhe njërit prej ministrave të parë që dolën nga Kongresi i Përmetit dhe Qeveria Demokratike e 22 Tetorit 1944 në Berat, Heroit të Popullit Haxhi Lleshi, se **"askush tjetër veç Enver Hoxha nuk mund ta udhëhiqte në fitore Luftën e Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare"** meriton të shkruhet në bronxin e historisë me gërma të arta sepse është pohimi i një të vërtete absolute. Ja përse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha ka meritën legjendare se luftën për çlirimin kombëtar e pa të lidhur ngushtë me luftën për çlirim shoqëror. Kjo luftë, në gjurmë gjaku e sipër, e udhëhequr me titanizëm nga Enver Hoxha, u shndërrua në një revolucion të madh popullor, dallgët e të cilit morën përpara divizione fashisto-naziste, tradhëtarë të vendit, bejlerë, agallarë, padronë e tiranë. Forcat e reaksionit, ballistët veçanërisht, e kuptuan se do të humbisnin pushtetin e tyre politik e ekonomik, e kuptuan se Enver Hoxha po e çonte rrjedhën e ngjarjeve në një revolucion antifashist, antifeudal, antikapitalist dhe për të shpëtuar pushtetin e tyre shpejtuan të radhiteshin krahu për krahu nazistëve gjermanë, por ishte tepër vonë. **Mendja gjeniale e Enver Hoxhës e kishte projektuar me kohë të ardhmën dhe dyert e pushtetit të tyre ishin të mbyllura.** Konferenca e Pezës, njëra ndër ngjarjet më të mëdha në historinë tonë kombëtare, me këshillat nacionalçlirimtarë, që përbënin një zhvillim krijues të marksizëm-leninizmit, po vendoste gradualisht pushtetin e popullit fshat më fshat e krahinë më krahinë. Enver Hoxha e kishte të qartë mësimin e Stalinit të Madh se Partia e komunistëve **"nuk e ndanë dhe nuk duhet ta ndajë udhëheqjen me parti të tjera"**. Specifikisht në Shqipëri as kishte me kë ta ndante, sepse partitë e tjera ishin bashkuar me nazizmin gjerman. Me Kongresin e Përmetit merr fund ëndrra e reaksionit për të krijuar ndonjë qeveri të hajrit që do t'u japë pushtetin. Kongresi flaku tej të gjitha marrëveshjet skllavëruese të regjimeve të kaluara në kurriz të popullit shqiptar dhe ndaloi kthimin e mbretit në Shqipëri. Kështu pas mbi dymijë e pesëqind vjet lufte për mbijetesë, liri e pavarësi për herë të parë populli shqiptar e pa veten zot në Atdheun e tij. Ja përse i është mirënjohës populli dhe historia Enver Hoxhës.

Enver Hoxha e konceptonte revolucionin popullor si një zinxhir betejash e jo si një betejë të vetme. Nuk ishte fjala vetëm për të zbatuar shpejt e me përpikmëri mësimet e "18 Brymerit" e të Leninit lidhur me zëvendësimin e makinës së vjetër burokratike dhe ushtarake, por edhe për një varg aksionesh e reformash të mëdha e mjaft të vështira, sidomos në një vend tejet të varfër e të prapambetur si Shqipëria.

Kishte rënë kështjella e nazifashizmit, kishte rënë kështjella e bejlerëve dhe agallarëve, por përpara ishin një seri kështjellash për t'u marrë nga armata popullore e Revolucionit: Kështjella e urisë, kështjella e analfabetizmit, kështjella e shkatërrimeve të luftës, kështjella e kanuneve mesjetare, kështjella e malarjeve dhe kënetave, kështjella e tmerrshme e gjakmarrjes, kështjella e mendësisë fisnore e një varg të tjera, midis të cilave dhe kështjella e mushkonjave dhe morrave.

Në betejat për të përmbysur njëra pas tjetra kështjella të zeza, Enver Hoxhës do t'i duhej të përballonte me mençuri e heroizëm prej revolucionari të jashtëzakonshëm edhe të paktën 5 mareshallë, **mareshall imperializmin anglo – amerikan** që planifikonte mbytjen e Republikës Popullore të 11 janarit qysh në djep e mosnjohjen e Qeverisë Demokratike dhe mospranimin e Shqipërisë në OKB; **mareshall reaksionin e brendshëm**, që edhe pse i mundur, shpresonte se komunistët i kishin të shkurtëra orët në pushtet dhe nisi veprimtarinë terroriste në banda bajraktarësh satanikë e me banda intelektualësh të pandreqshëm antipopullorë, me banda priftërinjsh tepër të rrezikshëm nëpër kishat që bënë sikur predikonin Jezusin, por në fakt ushqenin në popull virusin antikomunist të përmbysjes së pushtetit, deri me provokacione të armatosura terroriste si ai i Postribës në Shkodër, i cili u shtyp qysh në krismat e para siç meriton të shtypet një bandë terroriste; **mareshall shovinizmin** alla Caldaris, që i mbështetur dhe nga mareshall imperializmi amerikan dhe disa fuqi imperialiste evropiane, kishte predikime territoriale ndaj Shqipërisë e mbante në fuqi ligjin absurd të luftës me Shqipërinë; **mareshall shovinizmin serb e jugosllav me mareshall Josip Broz Tito** në krye, që synonte ta kthente Shqipërinë Republikë të Shtatë të Jugosllavisë dhe më në fund **mareshall tradhëtinë brenda gjirit të Partisë Komuniste** e në kokë të saj me në krye agjentin jugosllav Koçi Xoxe. Vetëm një gjeni i revolucionit mund t'i përballonte këto mori kështjellash e mareshallësh dhe të siguronte perspektivën e revolucionit.

Se dy rrugë ka: O të zbatosh **drejtësinë revolucionare** me kriminelët e luftës e kundërrevolucionarët e rinj e ta çosh kundërrevolucionin në gjyotinën e merituar, o të tregohesh i butë me kundërrevolucionin e të shohësh pastaj si ai i pret kokën revolucionit dhe i hedh popullit prangat e shtypjes e të shfrytëzimit.

Se dy rrugë ka: O t'i japësh popullit me **drejtësi revolucionare** tokën e pushtuar nga kriminelët latifondistë, siç ua dha Enver Hoxha përmes Reformës Agrare, o të puthesh me latifondistët e poseduesit e çifligjeve, që ata pastaj t'i thonë popullit të mjerë puthu me skllavërinë e me varrin.

Se dy rrugë ka: O të nxjerrësh me **drejtësi revolucionare** kodoshët borgjezë reaksionarë e Maria Antuanetat e tyre nga vilat e t'u marrësh qypet e floririt të fituar prej gjakut të popullit, o të tregohesh i butë me ta në emër të një humanizmi vdekjeprurës, që ata pastaj t'i thyjnë kokën popullit me qypat e tyre të kapitalit.

Enver Hoxha – dora e hekurt dhe e pamëshirshme e drejtësisë revolucionare kundër përbindëshave të pamëshirshëm bëri atë që duhej bërë. Ai nuk ra në gjunjë para xhelatëve kundërrevolucionarë siç ranë disa shokë të tij tradhëtarë në vitin 1990: **”Po dale, dale zotërinj xhelatë, si e doni ju pjatën, me pluralizëm mendimi a me pluralizëm partiak? Po dale, dale si e doni Atdheun, me monument heronjsh a me monumente kriminelësh? Si e doni shoqërinë, me demokraci popullore, a me demokraci xhelatësh?”**

Me Enver Hoxhën s'kish **“Dale, dale, si e doni dashin, të zierë në kazan apo të pjekur në hell?”** Me Enver Hoxhën kish: **Populli në pushtet, xhelatët e popullit në litar.**

Se po të bënte ndryshe, domethënë sipas modelit “dale, dale” më 29 Nëntor 1944 mund të festonte disa orë fitoren, por më 30 Nëntor 1944 do “festonte” disfatën. Kur populli t'i thosh: si e patëm fjalën Enver kur unë të besova djemtë e mi që derdhën gjakun?, si t'i përgjigjej Enveri popullit pastaj? Po ja, i dashur popull, unë nuk doja të plaste lufta civile, prandaj ti ngushëllohu me faktin që unë e dorëzova pushtetin tënd pa gjak, pa u vrrarë qoftë edhe një pulë, siç i thanë popullit udhëheqësit tradhëtarë të Partisë së Punës më 1990. Jo, një milion herë jo! Enver Hoxha do të udhëhiqte i detyruar edhe një luftë civile, siç e udhëhoqi i detyruar Lenini pas fitores së Tetorit shtatëmbëdhjetë. Ky ishte Enveri. Ligjet e popullit në fuqi i çuan në plumb e në litar

ata që i patën ngritur popullit litarin dhe kishin larë duart me gjak ose përpiqeshin t'i lanin akoma.

Armiqtë e sotëm të popullit fallsifikojnë të vërtetën, duke e lidhur drejtësinë revolucionare të popullit në fuqi me qenien e Enver Hoxhës komunist dhe me "krimet" e komunizmit. Po gjenerali Dë Gol i Francës, komunist ishte kur i çoi plot 12 mijë kolaboracionistë në plumb e në litar? Disa prej tyre ishin shkrimtarë nga më të dëgjuarit, që nuk i kishin lyer duart me gjak, por i kishin thurur himne nazizmit, apo se kishin bërë një fotografi me uniformë naziste, siç ndodhi me shkrimtarin dhe intelektualin e njohur Brozijak, për të cilin shumë intelektualë e shkrimtarë të njohur francezë u vunë në mbrojtje të tij e i kërkuan Dë Golit t'i falej jeta, po gjenerali nuk u tund nga parimet e tij dhe Brozijaku u pushkatua.

Për hir të realitetit gjenerali Enver Hoxha veproi krejt ndryshe me disa shkrimtarë e intelektualë të njohur që duart me gjak nuk i kishin lyer, por kishin bashkëpunuar me fashizmin, ndonjëri kish qenë dhe me ata që i çuan Viktor Emanuelit kurorën e Skënderbeut në Romë. Enver Hoxha as i vrau, as i burgosi, përkundrazi u krijoi kushte në zyrat e ngrohta të Tiranës të krijonin e t'i shërbenin popullit.

Pra komunisti Enver u tregua qindra herë më i duruar e më human se djathtisti dhe antikomunisti Dë Gol. Po ndërsa koha e këtij të fundit nuk akuzohet për krime të Golizmit, epoka e Enver Hoxhës akuzohet për krimë të komunizmit. Përse ndodh kështu? Sepse Dë Goli ishte udhëheqës dhe gjeneral i borgjezisë franceze dhe nuk e preku atë, prandaj Franca e sotme e konsideron ndër tre figurat më të mëdha të Francës krahas Zhan Darkës e Napoleonit. Ndërsa Enver Hoxha, figura më e madhe e historisë kombëtare, cilësohet nga borgjezia e sotme reaksionare e antikomuniste si e keqe kombëtare. Përse? Sepse Enver Hoxha ishte gjeneral dhe udhëheqës i popullit në fuqi. Sepse Enver Hoxha në emër të idealeve popullore u vuri kufirin te thana armiqve të brendshëm e të jashtëm që donin të zbrisnin popullin nga fuqia e mbi të të vinin djallin. Ja përse populli dhe historia i janë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha ka hyrë në histori si arkitekti i Shqipërisë së Re. "Shqipëria e Re" janë dy fjalë lehtësisht për t'u thënë, por për t'u bërë janë dashur shumë sakrifica, shumë energji, shumë heroizëm, shumë mençuri për të ecur në rrugë të pashkelur, shumë unitet gjithëpopullor. Enver Hoxha e mori Shqipërinë **pothuajse nag hiçi**: pa industri, pa bujqësi të zhvilluar, pa infrastrukturë, pa fronte pune, pa akademi e universitete, deri pa bukën e gojës, por me thes në shpinë për të blerë pak misër. Populli më i vjetër i Ballkanit e sipas shumë historianëve të huaj me gjuhën më të vjetër të Evropës, përveç thesarit të patriotizmit të trashëguar e të një qëndrese legjendare mijëra vjeçare për të mos u asimiluar, s'kish asgjë tjetër. Më 1945 ky ishte thjeshtë një popull i mbijetuar, i çliruar nga fashizmi dhe forcat e shtypjes e të shfrytëzimit brenda vendit, por këmbëzbathur, tmerrësisht i varfër e i prapambetur, si dhe tmerrësisht i rrethuar e i kërcënuar nga armiq të shumtë.

Për të kurorëzuar betejën për socializmin Enver Hoxha e kuptonte se duhej të kryente njëmijë e një revolucione në të gjithë sektorët e jetës, një nga një e paralelisht, i udhëhequr nga marksizëm-leninizmi, veç jo sipas klisheve të gatshme të një vendi të tjetër socialist, sepse të tilla ishin rrethanat. Shqipëria nuk ishte Çeki, për të cilën mjaftonte një përvojë e një vendi tjetër si Bashkimi Sovjetik për të ndërtuar socializmin.

Në bazë të një programi madhështor të hartuar nga Enver Hoxha me shpejtësi të jashtëzakonshme u arrit **shkollimi i mbarë popullit** dhe zhdukja e analfabetizmit shekullor. Enver Hoxha e çoi shkollën e mesme në fshatrat më të thella të malësisë ku askujt s'ia priste mendja dikur, shkollat që sot janë shkatërruar. Një krim ky i kapitalizmit. Me shpejtësi të jashtëzakonshme u arrit krijimi i një rrjeti shëndetësor në

gjithë vendin, rrjet që sot është shkatërruar dhe humanizmi mjekësor është kthyer në xhelatëri njerëzore. Një krim ky i kapitalizmit. Me shpejtësi të jashtëzakonshme u luftua për bonifikimin e mekanizimin e bujqësisë dhe zhvillimin e kthimin e saj nga primitive në të përparuar, e mundshme për të siguruar bukën në vend. Kjo bujqësi sot është shkatërruar. Një krim ky i kapitalizmit. Me shpejtësi të jashtëzakonshme u krye industrializimi i vendit me një gjerdan të tërë e madhështor uzinash, fabrikash, minierash, kombinatesh, hidrocentralesh të përhapura në gjithë vendin e që bënë të mundur zhdukjen e papunësisë dhe krijimin e një klase të re punëtore. Ky korpus madhështor e kjo klasë sot janë shkatërruar. Një krim ky i kapitalizmit. Me shpejtësi e heroizëm të jashtëzakonshëm u krye elektrifikimi i plotë i vendit, vepër madhështore kjo që u shkatërrua. Një krim ky i kapitalizmit. E kur ballafaqohen ndërtimet e socializmit me shkatërrimet e krimet e kapitalizmit s'ka se si populli dhe historia të mos i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha me politikën e tij njerëzore i siguroi shqiptarit **të drejtën** për të **punuar**, **të drejtën** për t'u **shkolluar** falas, **të drejtën** për t'u **shëruar** falas, **të drejtën** për të qenë **në pushtet**, **të drejtën** për **një jetë të siguar**. E që të gëzonte populli këto të drejta, Enver Hoxha u hoqi kriminelëve të drejtën për të sabotuar, të drejtën për të tradhëtuar Atdheun dhe të drejtën për të vrarë njerëz. Enver Hoxhës i përket merita e ndalimit të gjakmarrjes, një plagë kjo nga më të shëmtuarat, që kombet e Evropës nuk e njihnin. Sot del ndonjë organizatë mafioze, gjoja për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në folenë e së cilës disa qenër e laraska mbjellin farën e gjarpërit dhe akuzojnë Enver Hoxhën për shkelje të të drejtave të njeriut, në një kohë kur njeriut i është rrezikuar e drejta për të jetuar, në një kohë kur në 17 vjet Nëna Shqipëri numëron **mbi 40 mijë të vranë e të vetëvranë, të mbytur në det e të humbur**, në një kohë kur është rikthyer plaga e gjakmarrjes, në një kohë kur në Shqipërinë e kriminelëve kapitalistë **ka fëmijë të ngujuar**, tmerr ky që nuk e përjeton asnjë komb i Botës, në një kohë kur çdo ditë kërcet kallashnikovi dhe vriten njerëz e mbyllen nëpër kulla ngujimi familje e fise të tëra. Enver Hoxha e pati **mbyllur këtë tragjedi** që sot e vesh Shqipërinë me të zeza. Ja përse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha e shkriu jetën e tij si qiriri për emancipimin e gjithë shoqërisë e në veçanti të gruas. Sot të drejtat e gruas prapë janë dhunuar. Imponimi ndaj partive politike që në listat parlamentare të planifikojnë 30 për qind gra është një shou arifical, është një fyerje për gruan, jo nderim. Edhe në këtë 30 përqindsh nuk do të jenë gratë e vegjëlisë, po disa llafazane e intrigante të shtresave të pasura. Në parlamentin socialist vinin heroinat e punës e të revolucionit, sot vijnë heroinat e degjenerimit e korrupsionit. **S'mund të ketë çlirim e emancipim të gruas pa çlirim e emancipim të gjithë shoqërisë**, siç ndodhi në socializëm, ku Shqipëria e pa vetëm në lartësi të paimagjinueshme më parë. Enver Hoxha më 1945 nuk lëshoi kushtrimin rrëmbe o popull lugën e floririt e ha me lugë floriri, po lëshoi kushtrimin për **bukë e kulturë**. Luga e floririt u premtua më 1990, por popullit ia dha luga e kurbetit. Nën flamurin e Enver Hoxhës arti dhe letërsia, shkenca dhe kultura me institucionet e tyre, ku milionin disa mijëra intelektualë të formuar në socializëm, premtinin për lartësi të reja. Një mori transformimesh të mëdha treguan epërsinë e rendit socialist mbi atë kapitalist, politikën e drejtë ekonomike të Partisë në pushtet, udhëheqjen frymëzuese, organizuese, mobilizuese dhe triumfuese të Enver Hoxhës. Ja përse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Një revolucion i thellë ideologjik dhe kulturor dha frutet e shumëpritura në çdo fushë të jetës. Feja e shqiptarit u bë me të vërtetë **shqiptaria**, siç ëndërronte rilindasi Vaso Pasha. Një shqiptari për Shqipërinë e dalë, siç ëndërronte Naim Frashëri i madh, në dritën e diturisë. Në procesin e këtij revolucioni të gjithanshëm nuk doli ndonjë inisiativë nga Partia a urdhër nga Enver Hoxha të ndalohej besimi fetar, sepse **komunistët i respektojnë ndjenjat e njerëzve rrënjësor në shekuj**, por është e vërtetë se u ndaluan me kërkesë të rinisë institucionet fetare dhe natyrisht u luftua me durim e urtësi kundër besimeve të kota. Le të thonë ç'të duan, Shqipëria ateiste që një fitore e madhe. Njeriu është i lirë të besojë, por dhe një shoqëri e emancipuar duhet të jetë e lirë t'i thotë njeriut se për çfarë është mirë të besojë.

Apologjetët e borgjezisë dhe teologët e fesë kanë dashur ta paraqesin komunistin Enver Hoxha dhe Shqipërinë socialiste si të parin dhe të vetmen në botë kundër fesë. Por historia e njerëzimit flet ndryshe. Iluministët francezë të mbi dyqind vjetëve më parë nuk ishin as komunistë e as agjentë të Shqipërisë socialiste që u ngritën kundër fesë i kishës franceze. Marksia dhe Engelsi nuk ishin shqiptarë, po gjermanë. Ata e thanë se **feja ishte opium për popullin**. Ishte rinia revolucionare ajo që me vrullin e saj u ngrit kundër institucioneve fetare. Enver Hoxha nuk bëri gjë tjetër vetëm se e mbështeti rininë, fidanishten e kuqë të Atdheut tonë socialist. Flamurin kundër fesë e pati ngritur madhërisht shumë vite më parë një i ri shqiptar i quajtur Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni, lajmëtar i madh i së resë. **“Na t’birt e shekullit të ri, që plakun e lamë në shenjtinë e tij”** pati gjëmuar Migjeni. Ishte dhe zëri i Migjenit ai që u ndez në zërin ateist të rinisë sonë zemërzjarrtë e mendjendritur dhe ngriti grushtin me luftu të vjetrën në emër të së resë. Rinia jonë nuk u tha asgjë më tepër klerikëve se sa i madhi Viktor Hygo i tha klerikut: **“Unë nuk e dua dogmën tënde. Unë nuk e dua zjarrin tënd mbi tokë dhe ferrin tënd në qiell”**.

Sot të paktën me ligj në të gjithë botën ndalohet përdorimi i skllavërisë, por njëra nga kalatë e skllavërisë, feja, mbahet në këmbë pothuaj në të gjithë botën, jo sepse borgjezëve të pashpirt kapitalistë e imperialistë u digjet zemra për fenë, por sepse ajo është një kala që u shërben atyre për shfrytëzimin e popujve dhe të mbarë njerëzimit. Këtë kala me mbretërit e saj të bindur e përdori jo pa fitim kapitalizmi për të përmbysur socializmin. Kisha serbe e reklamon veten sot si institucion të engjëjve dhe të zotit, por nuk mallkon djajtë shovinistë serbë që për 100 vjet kanë vrarë e kanë prerë kosovarët, përkundrazi, nuk merret me punët e zotit, por në mënyrën më kriminale nxit popullin serb kundër Kosovës. Jo vetëm Kosovën, por kisha serb edhe dy gra heroike serbe, **Sonja Biserko dhe Natasha Kandiç**, që mbrojnë të drejtat legjitime të popullit kosovar do të ishte gati t'i digjte në furrën e druve si Zhan Darkën dikur, duke e treguar veten para gjithë botës se nuk është aspak institucion i zotit, por institucion i djallit. **Kurrë nuk do të ketë njerëzim plotësisht të çliruar pa u çliruar edhe nga feja. Bota do të jetë e çliruar nga verbëria, telat me gjemba të burgjeve të padrejta dhe nga gijotina e xhelatëve dhe tiranëve vetëm kur të jetë e çliruar edhe nga mjekrrat e priftërinjve dhe hoxhallarëve.**

Enver Hoxha sa që gjallë mbështeti çdo nismë progresiste në shërbim të së resë, luftoi si titan të na çlirojë nga çdo e keqe, të jemi njerëz të rinj dhe të shohim përpara nga e reja. Ja përse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Sot të gjithë djajtë e kapitalit dhe të injorancës ekstreme tallen me njeriun e ri për të cilin luftoi Enver Hoxha në Shqipëri. Tërë llumi i shoqërisë së sotme tallet me njeriun e ri, duke e paraqitur atë një fenomen fantazist, që s'ka ekzistuar kurrë. Njeriu i ri është parë për 50 vjet edhe si individ dhe masivisht në Shqipëri, sepse pa të nuk mund të kapërceheshin shekuj varfëri e mjerim. Njeriu i ri ishte ai që shkonte drejt vdekjes për të shpëtuar shokët në galeri apo hidhej në zjarr për të shpëtuar pasurinë

socialiste, që rrokte qiellin me krahë kur shpërthente një pus i ri naftë, që rrinte me javë të tëra në fund të detit në nëndetëse, që thinjej piramidave të kufirit. Njeriu i ri ishin ata mijëra punëtorë e fshatarë që gjakun dhe djersën e tyre e kthyen flori për shtetin që ky, veç të tjerash, të rriste nëpër shkolla dhe akademi mbi 100 mijë intelektualë. Dhe nuk është faji i njeriut të ri që këta intelektualë e harruan këtë investim dhe na dolën një ditë lakuriq me pamjen e njeriut të zi. Nuk mund të shkonin në frontin heroik të prodhimit mijëra punëtorë pa njeriun e ri kuadër e drejtues të tipit **Todo Manço, Gogo Nushi, Dhimitër Brisku** e qindra si këta. Nuk mund të shkonin mirë punët në asnjë front nëse njeriu ynë s'do të ish i bindur për punën e sakrificën. Shqipëria e vogël u kthye si një ishull i bukur e i pastër në mes të një kënete globale dhe kjo i detyrohet pikërisht Enver Hoxhës e njeriut të ri. Por edhe njeriu i ri, veçanërisht në rrethana tradhëtishtë të mëdha e përmbysjesh të mëdha nuk është i imunizuar nga helmi. Janë shumë rrethana që e kthejnë atë në viktimë dhe e detyrojnë t'i kundërvihet dhe vetvetes. Sa ishte në këmbë e në shtet njeriu i ri me besimin në Enver Hoxhën, në Shqipëri nuk pati si sot poshtërim, nuk pati si sot papunësi, nuk pati si sot gjak e gjakmarrje, nuk pati si sot pranë e pranë të uriturin e miliarderin, nuk pati si sot shkatërrim e përvehtësim të ekonomisë kombëtare, nuk pati si sot korrupsion në pushtet e në bazë, nuk pati si sot injorancë e analfabetizëm, nuk pati si sot fëmijë që vrasin prindërit e vdekje të përditëshme jo natyrale, nuk pati si sot degjenerim moral e shkatërrim të familjes, nuk pati si sot mashtrime të pakufi prej qeveritarëve, nuk pati si sot tmerr e panik për të nesërmen. Ja përse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha ishte një demokrat i madh. Më i madhi i gjitha kohërave. Argumenti është fare i thjeshtë. Enver Hoxha në të gjithë jetën e tij mbi gjithçka vuri popullin, popullin dhe prapë popullin. Në konceptin e Enver Hoxhës edhe Partia duhet të ishte nën kontrollin e popullit, **sepse është populli, theksonte Ai, që vërteton në praktikë drejtësin e vijës e të vendimeve të Partisë.** Enver Hoxha kurrë nuk e konceptoi Partinë me të drejta të pakufizuara. Në fjalimin historik të Matit Enver Hoxha e ka theksuar fort këtë çështje kur referoi për demokracinë socialiste. Në konceptin e Enver Hoxhës **të drejtën e pakufizuar mund ta kishte vetëm popullin.** Populli ishte plotësisht i lirë të sulmonte e të shpartallonte burokratizmin e burokratët, të cilët Enver Hoxha i konsideronte me të drejtë armiq të popullit. **Besimi i Enver Hoxhës tek masat e vija e masave ka qenë kurdoherë. Kryesorja në doktrinën e Marksit, shkruante Lenini, është sqarimi i rolit historik të proletariatit si krijues i shoqërisë socialiste. Socializmin e ndërtojnë masat, Partia i bën ato të ndërgjegjshme shprehej Enver Hoxha, duke i dhënë njëherësh rëndësi të dorës së parë rolit të klasës së re punëtore në shoqërinë e re socialiste.**

Enver Hoxha besonte në një perëndi. Perëndia e tij ishte populli. Ishte njeriu. Askush si Enver Hoxha nuk shqetësohej për njeriun, qoftë ky veteran i luftës e qoftë veteran i punës, qoftë nënë dëshmori e qoftë bijë patrioti, qoftë ky Hero i Popullit apo shencëtar e artist i kualifikuar, qofshin këta korifej si **Odise Paskali e Abdyrrahim Buza**, qofshin këta gurëgdhëndës apo artistë popullorë si **Fatime Sokoli, Laver Bariu e Demir Zyko.** Në një vepër kolosale me mbi 100 volume, po të botohej të tëra, **nuk gjen dot qoftë dhe një frazë a një fjalë që të bjerë në kundërshtim me parimet demokratike e me njeriun.** Por në kundërshtim me këto parime ka patur edhe armiq të fshehtë, brenda në elitën e Partisë, të cilët e kishin frikë popullin e s'mund të dilnin hapur kundër Enver Hoxhës, ama e sabotonin fjalimin e Matit, sabotonin idetë e Enver Hoxhës për demokracinë popullore e socialiste, luftonin të ngjallnin pakënaqësi në popull. Pas vdekjes së Enver Hoxhës armiqtë ia dolën në krye të përmbysnin sistemin socialist me kundërrevolucionin, por kurrë nuk ia dolën

dot që shumicën e popullit ta hedhin kundër Enver Hoxhës. **Sot në Shqipërinë e turpit për një kategori njerëzish anormalë 100 vjetori i Enver Hoxhës mund të përmendet si i një diktatori, por 200 vjetori i Tij do të përkujtohet me nderim e madhështi si i një Shenjti. Ja përse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.**

Enver Hoxha që në hapat e tij të parë në jetën politike rrezatoi një individualitet krejt të ndryshëm me filozofë e politikanë të tjerë brenda e jashtë Atdheut. Teoricienët dhe filozofët tanë as që janë ndalur ndonjëherë në këtë veçaninë kur janë marrë me përmasat e Enver Hoxhës si politikan. Mendimi i tij filozofik shtrihet i qartë dhe i thjeshtë në të gjitha veprat e tij të natyrës shkencore dhe publicistike, në raporte kongresesh e fjalime të rëndësishme. Në mendimin filozofik të Enver Hoxhës nuk gjendet qoftë dhe një frazë e diskutueshme dhe e kontestueshme.

Përmasat dhe individualiteti i politikanit Enver Hoxha mund të pasqyrohen me dy fjalë: **Arti dhe shpata**. Në gjithë jetën e tij aktive politike, që nga 8 Nëntori 1941 e deri në fund të jetës artin e politikës Enver Hoxha e vuri në funksion të popullit. Politika në duart e tij nuk mund të konceptohet ndryshe vetëm si një shpatë dhe vetëm si një shpatë. Ndryshe nga politikanët e kohës në të cilën jetoi, Enveri nuk preferoi të zëvendësonte shpatën e politikës me ndonjë armë tjetër. Si dje e si sot i kemi parë e i shohim politikanët herë të dalin në fushën e luftës politike me topa e herë me çifte, herë me flamurë të zi e herë të bardhë, herë me daulle e herë me gërnëtë, herë me vargoj e herë me def, por s'kemi parë asnjë politikan të dalë gjithë jetën me një fytyrë, me një flamur, me një shpatë si Enveri. Edhe kur kanë tentuar ndonjëherë ta përdorin këtë armë, ose e kanë nxjerrë nga milli para kohe, ose e kanë nxjerrë në kohën e duhur, por pas pak orësh janë detyruar ta flakin shpatën në kënetë e të rrëmbejnë pa pikë turpi defin. Kujtoni Nikita Sergejeviç Hrushovin, këtë frikacak e klloun të kampit socialist, në krizën e raketave të Kubës. Si mjeshtër i politikës së madhe që ishte, Enver Hoxha mund të bënte edhe një tërheqje taktike, por vetëm në interes të objektivit të tij strategjik dhe natyrisht pa e flakur shpatën besnike e triumfale.

Enver Hoxha ishte ndër ata politikanë e burra shteti që mendohej mirë për të nxjerrë shpatën nga milli, por po ta nxirrte i qëndronte situatës. Këtë të veçantë të tij e dinin fort mirë dhe kundërshtarët e tij imperialistë. Nëse ata projektonin për shembull një provokacion ushtarak si për të matur pulsën në gjirin e Vlorës nëpërmjet NATO-s e Flotës së Gjashtë e nëse informoheshin përmes agjentëve të tyre se Enver Hoxha dha urdhërin që po të prekej iks koordinatë të hapej zjarr, duke e ditur që Enver Hoxha nuk ishte burrë shteti e politikan i shakarave, tërhiqeshin menjëherë. Jo pse anijet e tyre do të varroseshin në fund të detit e do të humbisnin disa miliona e miliarda dollarë. Jo për këtë humbje ekonomike, se ajo tek e fundit nuk ishte për përcaktimin veçse një pikë uji në oqean. Ata tërhiqeshin për të mënjanuar humbjen kolosale politike në sy të Botës. Gjithë bota do të ziente: Shqipëria e vogël sfidoi përcaktimin e madh.

Kur brezat e studiuesve gjakftohtë e realistë do të mund të portretizojnë Enver Hoxhën si politikan i përmasave botërore, mbështetur mbi fakte e ngjarje të dokumentuara, njerëzit kanë për të ndjerë atë krenari të ligjshme kombëtare që ndjen çdo shqiptar i ndershëm për një shqiptar kaq të madh e të fortë. Edhe populli me intuitën e tij Enver Hoxhën si politikan e burrë shteti e "pikturoi" në këngët e tij vetëm me shpatë. "Enver Hoxha e mbrehu shpatën" thotë një varg i një kënge popullore shumë të njohur. Të mos qe kjo shpatë, thikën e reaksionit brenda dhe jashtë do ta kishim marrë në zemër me kohë. Ja pse populli dhe historia i janë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha nga i gjithë koalicioni i bandës politike të ditëve tona cilësohet si diktator. Bile edhe nga disa zotërinj insekte të medias së përditshme të shkruar e vizive, të cilët, për të ngrënë një tas supë të prishur, nuk thonë qoftë edhe një fjalë kundër diktatorëve të gjallë që i kanë shaktuar gjëma të paimagjinueshme popullit tonë në këto dekada të fundit, por hapin “Kutinë e Pandorës” që u ka dhuruar fati i përkohshëm, nxjerrin prej saj fjalën “diktator” dhe etikojnë me të një udhëheqës historik që nuk është i gjallë fizikisht. Enver Hoxha, si edhe udhëheqës të tjerë komunistë, nuk e ka fshehur ndonjëherë që në Shqipëri u vendos diktatura e proletariatit dhe se kjo diktaturë duhet të mbahet e gjallë për një kohë të gjatë deri kur të mos ketë nevojë për shtet, por ai kurrë nuk e vuri veten në rolin e diktatorit. Diktatorët e kanë frikë arsimimin e popullit. Enveri, përkundrazi, ishte komisar i madh i arsimit të popullit. Diktatorët e kanë frikë, shumë frikë popullin dhe bëjnë të nëntëdhjetenëntat për ta mbajtur të çarmatosur. Enveri, përkundrazi, armatosi gjithë popullin që të mbronte lirinë e nderin e vet.

Ndryshe nga Enver Hoxha e udhëheqësit komunistë, udhëheqësit kapitalistë e imperialistë, diktatorët e përkundur dhe të formuar me doktrinat e diktaturave antinjerëzore të shekujve kanë për mision të mbajnë në këmbë një sistem të tërë diktatorial, forcojnë çdo orë diktaturën e një grupi për të mbajtur nën diktaturë gjithë popullin. Një president amerikan, do apo nuk do shumica e popullit amerikan, do apo nuk do Kongresi amerikan, do apo nuk do OKB-ja, **vendos veton, shpall luftra**. Ky është diktatori, pjellë e vetë sistemit.

Në sistemin socialist, edhe sikur të duash, nuk mund të kthehesh në diktator, pasi nuk sundon njëshi si në sistemin borgjez, por sundon kolegjaliteti, sundon shumica. Ky sistem nuk e pranon veton. Sistemi socialist e ka një armë për të mbrojtur popullin, atë që quhet diktaturë e proletariatit, por udhëheqësit kryesor të shtetit nuk ia jep kurrë të drejtën e vetos që ta përdorë këtë armë si të dojë.

Diktatorët ose vijnë në pushtet sipas rregullave të sistemit të diktaturës borgjeze, ose me puç ushtarak, siç kanë ardhur gjenerali Franko, gjenerali Pinoçet e qindra të tjerë. Enver Hoxhën e solli në krye të vendit revolucioni popullor dhe e mbajti në krye po revolucioni popullor, duke i shprehur tërë respektin dhe nderimin për meritat e besnikërinë ndaj revolucionit, por duke mos i lënë njëherësh asnjë mundësi ligjore të kthehej në diktator.

Enver Hoxha nuk ishte as President i Republikës, as Kryeministër pas viti 1954, por vetëm Sekretar i Parë Partie. Kushtetuta i kishte dhënë të drejtën të ishte Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, por mbi të qëndronte Këshilli i Mbrojtjes, ku vërtetë ishte Kryetar, veç jo me të drejtë vetoje. Edhe në këtë organizëm ai kishte vetëm një votë. Dhe pse qëndronte në postin më të lartë partiak Enver Hoxha **as e kishte në natyrë** dhe as e përdori të drejtën të caktonte vetë një ministër si diktatorët e sotme, as një kryetar komiteti, as një kryetar këshilli fshati. Në dyzet vjet socializëm Kushtetuta është diskutuar dy herë, është hartuar dhe diskutuar e miratuar në popull, qytetar për qytetar. Enver Hoxha as në ëndërr nuk mund ta shikonte të ndryshonte kushtetutën sipas qejfit të vet, siç ndodh me diktatorët e sotëm që e përdorin Kushtetutën si një leckë për të fshire sa herë të duan duart e tyre të përgjakura. **Jo shumë larg, por vetëm natën e 21 prillit 2008, dy diktatorë të urryer, Sali Berisha dhe Edvin Rama, modeli më i zi i diktatorëve të Evropës së ditëve tona, ndryshuan Kushtetutën dhe Republika Parlamentare në fakt u kthye në Republikë Kryeministore, kryeministri është në rolin e mbretit suprem.** Enver Hoxha nuk veproi kurrë si mbret, por ama kur populli e informoi për një padrejtësi, qoftë dhe me një letër, Ai ndërhynte me autoritetin e tij të padiskutueshëm të bëhej det e tërmet, të vihej në vend e drejta dhe të ndëshkohej padrejtësia. Enver Hoxha e kreu me nder e lavdi detyrën e tij para popullit sa që gjallë, duke drejtuar që populli të

mos shtypej e shfrytëzohej nga diktatorët dhe diktaturat antipopullore. Ja përse populli dhe historia i janë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha pati një rol përcaktues për mbrojtjen e revolucionit dhe si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Nën drejtimin direkt të Enver Hoxhës forcat i Sigurimit të Shtetit asgjësuan të gjithë bandat terroriste që stërvitën e hodhën në Shqipëri anglo-amerikanët. Vetë kryeministri anglez Toni Bler është detyruar të pranojë botërisht se Inteligjent Servisi Anglez në luftën për rrëzimin e regjimit të Enver Hoxhës kishte dështuar.

Nën drejtimin direkt të Enver Hoxhës u rrit e u zhvillua një **ushtri e fuqishme dhe e pamposhtur popullore**, mbrojtëse e sigurtë e trojeve tona dhe e fitoreve të revolucionit popullor. Historia e Ushtrisë sonë Popullore nën komandën e Enver Hoxhës mund të thuhet pa hezitim se përbën një mrekulli të shekullit. Armata e oficerëve të Ushtrisë sonë Popullore ka qenë plotësisht e merituar për t'u quajtur Armata e Heronjve të Shekullit. E zgjedhur thuajse totalisht nga bijtë e punëtorëve dhe fshatarëve, e formuar atdhetarisht, ushtarakisht e politikisht në shkollat dhe akademitë tona ushtarake, veçanërisht qysh në vegjëli në Shkollën e famshme Ushtarake "Skënderbej", kjo armatë mbeti gjer në fund shtylla më e artë dhe më besnike e qëndresës popullore dhe e Komandantit të saj të madh.

Nën drejtimin direkt të Enver Hoxhës **u realizua si domosdoshmëri ideja e popullit ushtar**. Dhe i përket merita kësaj armate oficerësh që me besnikëri e sakrificë mbinjerëzore realizoi në praktikë idenë e madhe të Komandantit të madh. Enver Hoxha e kuptoi se në rrethanat kur Shqipëria duhej të përballonte bllokadën e madhe imperialiste dhe socialimperialiste, që do të arrinte deri pothuajse në bllokadë botërore, në rrethanat ku ajo ishte si kundër NATO-s e si kundër Traktatit të Varshavës, **e vetmja rrugë shpëtimi ishte armatosja e mbarë popullit**, fortifikimi i madhërishtëm i kufijve detarë dhe tokësorë, siguri i teknikës dhe municioneve për vite të tëra lufte mbrojtëse, mbi të gjitha edukimi patriotik dhe ushtarak i këtij populli ushtar, që do të komandohej nga aftësia e oficerëve proletarë dhe jo nga bijtë e borgjezëve e hija e gradave.

Në një truall madhërisht të fortifikuar, në një tokë ku mbrojtja ushtarake kish siguruar që të mos mbetej asnjë milimetër kënd i vdekur, po e tërë të mbulohej nga zjarri i armëve, çdo fuqi e huaj që do të tentonte të sulmonte Shqipërinë do të gjente vdekjen e sigurtë. Të desantoje e të goditje mbi Shqipërinë socialiste ishte njësoj si të desantoje e të goditje mbi një bombë atomike, nga shërthimi i së cilës mund të tronditej e tërë Bota. Asnjë shtet i botës, qofshin këto edhe superfuqi, nuk ia arriti që në çdo tremilionë popull, dy milionë të ishin ushtarë siç ia arriti Enver Hoxha, ky gjigand që e kthente të arritshme atë që liliptutët e konsideronin të paarritshme. Me cilëndo ushtri të bllokut komunist, përjashtoj Bashkimin Sovjetik, është shprehur një gjeneral i NATO-s, ne do të mateshim e do të fitonim me lehtësi, por ne nuk mund të rrezikonim me Shqipërinë e vogël me një Komandant Ushtarak si Enver Hoxha.

Disa tradhtarë e skllëvër të imperializmit, njerëz pa Atdhe, derdhin sot lot krokodili, mallkojnë disa bunkerë betoni ngritur për të mbrojtur jetën e shqiptarëve, lirinë e nderin e Atdheut, gjoja se këta paskan dëmtuar ekonominë. Tradhtarët e të gjitha ngjyrave nuk i ha merakun e ekonimisë, se ata ekonominë e hodhën në erë dhe e grabitën sapo erdhën në pushtet, por i ha merakun përse ushtria e Enver Hoxhës mbrojtiti Atdheun socialist. Disa të tjerë i ha merakun e gradave e i ushtrisë së kazermës, që të rronin me privilegje gjeneralësh, që të sundonin kastat ushtarake. **Një ushtri popullore dhe një popull ushtar udhëhiqet me ide e parime, me taktikë e strategji të përsosur ushtarake, jo me grada e kasta ushtarake.** Enver

Hoxha i hoqi edhe vetë i pari gradat dhe nuk lejoi që revolucionin popullor ta rrezikonin kastat.

Tradhëtarët e ditëve tona, pasi vranë ushtrinë e lavdishme të Enver Hoxhës, pasi e shkatërruan me turp para gjithë Botës më 1997, - një tragjedi unikalë kjo që bota kurrë s'e kishte parë, - pasi kthyen në skrap 1'100 tanke modernë nën buzëqeshjen rozë të Pandeli socialistit, pasi shkatërruan flotën luftarako-detare e ajrore, bazat e raketave, si dhe të gjitha uzinat ushtarake, pasi shitën teknikë e armatim 17 vjet rresht pa pushim, pasi e çarmatosën totalisht një popull që armën e deshi si fëmijën, pasi hoqën nga fjalori deri emërtimin "Ushtri e Popullit", mburret sot se do të hyjmë në NATO e do të na mbrojë NATO-ja. Po, NATO-ja do t'i çojë bijtë e varfërisë e mjerimit nizamë si në kohën e Sulltanit, siç i çon sot në Irak, ndërsa ushtarët e tij do të jenë zot i këtij Atdheu të tradhëtuar e padyshim do të bëjnë edhe pak dashuri me vajzat, motrat dhe gratë e pushtetarëve. E kjo ndodh se ka vdekur Enver Hoxha, i cili nuk e ktheu Shqipërinë plasdarm bazash të huaja ushtarake kundër popujve, përkundrazi, sapo e kuptoi se Hrushovët e Malinovskët synonin ta kthenin Bazën e Vlorës të keqen e popujve të Mesdheut, i ndoqi rusët prej saj, duke kryer kështu detyrën e njeriut të Paqës për popujt e Mesdheut, edhe pse qeveritë e këtyre popujve s'ia ditën për nder. **Kush është për Paqen duhet të jetë me Enver Hoxhën dhe të kërkojë një Ballkan dhe Evropë në paqe, pa baza të huaja ushtarake.**

Skënderbeu në kohën e tij në krye të një populli të vogël u ndesh me perandorinë më të madhe të Evropës dhe falë aftësive të tij të rralla si strateg ushtarak rezistoi për 25 vjet e shpëtoi krishterimin evropian. Enver Hoxha në kohën e tij në krye po të këtij popull të vogël, falë aftësive të tij të rralla si strateg ushtarak, rezistoi jo vetëm përballë një perandorie, por përballë dy perandorive të shpallura amerikane dhe sovjetike, dhe jo vetëm përballë këtyre, por dhe përballë shumë shteteve të mëdha armike të fqinjëve më të afërt e "fqinjëve" më të largët që mund të thuhet se përbënin perandorinë e tretë.

Do apo s'do ta pranojë kjo botë, historia nuk mund të jetë e paturpshme të mos pohojë se Enver Hoxha si komandant ushtarak në krye të tre milionë shqiptarëve u rezistoi tre perandorive botërore që arrinin e kalonin miliardin. S'ka asnjë fije dyshimi se tre milionë shqiptarë me Komandant Enver Hoxha do të mund të rezistonin para tre perandorive dhe tremijë vjet. Ja pse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha ishte sa mendimtar i madh marksist-leninist aq edhe luftëtar i pamposhtur aktiv kundër çdo oportunizmi e shtrembërimi të kësaj doktrine. Pas vdekjes së Stalinit revizionizmi doli në skenën e historisë si një **revizionizëm tashmë në pushtet** e që përbënte rrezikun fatal ta çonte kampin socialist në katastrofë. "Telefoni i kuq" Moskë – Uashington në sytë e Enver Hoxhës ishte gjunjëzim ndaj imperializmit e tradhëti e lartë ndaj popujve heroikë sovjetikë, tradhëti e lartë ndaj 27 milionë ushtarë sovjetikë që dhanë jetën për shpëtimin e mbarë njerëzimit nga murtaja nazifashiste, tradhëti e lartë ndaj gjithë popujve të kampit socialist e njëherësh gjithë popujve të Botës që aspironin për liri e pavarësi.

Pas vdekjes së Stalinit, Enver Hoxhës i ra barra e rëndë të ngrihej fillimisht i vetëm kundër tradhëtisë më të madhe që i ishte bërë ndonjëherë komunizmit dhe të denonconte me guxim e largpamësi legjendare para gjithë Botës që nga salla Gjeorgjevskaja e Moskës revizionizmin modern me atë Hrushovian në krye, duke zbuluar e argumentuar thjeshtë, qartë e prerë shkaqet objektive dhe subjektive të lindjes së revizionizmit modern, duke i bërë të njohur lëvizjes komuniste botërore se ky kundërrevolucion revizionist, kjo strategji e tij regresive, kjo puthje e shëmtuar me imperializmin, po gërmonte varrin e socializmit, po çorodiste e po krijonte konfuzion e

po çonte drejt mbyttjes lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Në fjalën e tij historike në Moskë e në qindra fjalime të tjera si dhe në një varg veprash madhore, mes të cilave “Imperializmi e revolucioni”, “Eurokomunizmi është antikomunizëm”, shumë aktuale edhe sot e kësaj dite, Enver Hoxha demaskoi dhe praktikën revizioniste, argumentoi shkencërisht se mësimet e Marksit, Leninit dhe Stalinit nuk ishin plakur, se natyra e imperializmit nuk kishte ndryshuar, dhe se **“Tezat gjeniale të Leninit mbi imperializmin i vërteton jeta vazhdimisht”**.

Mbrojtja e shkëlqyer që Enver Hoxha i bëri për dyzet vjet me radhë Marksizëm – Leninizmit, lufta e tij legjendare kundër revizionizmit modern, përcaktimi prej tij i epokës sonë si epoka e revolucioneve proletare e nacionalçlirimtare; parashikimi prej tij se kanceri revizionist do t’i çonte vende të tilla si Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavia deri në shpërbërje, siç ndodhi në të vërtetë, e të tjera e të tjera, i dhanë këtij revolucionari parimor e konsekuent **vulën e marksist-leninist më të madh të kohës dhe përmasat e një personaliteti heroik me vlera të rëndësishme ndërkombëtare**.

Kjo vepër e Enver Hoxhës kundër revizionizmit përbën njërin prej kapitujve më të artë të historisë së Partisë së Punës së Shqipërisë. Ajo duhet të ishte pikë referimi për çdo komunist të vërtetë e parti marksiste-leniniste në botë, veçanërisht për Partinë e Punës së Shqipërisë. Por pas vdekjes së Enver Hoxhës, edhe pse Komiteti Qendror i Partisë dhe Byroja e tij Politike deklaroi me demagogji pompoze vazhdimësinë e marshit në rrugën e Enverit, në realitet udhëheqja e Partisë pa kaluar as gjashtë muaj dha sinjalin e parë të kalimit në rrugën e revizionizmit.

Për të dhënë këtë sinjal kjo udhëheqje gjeti pikërisht momentin e 16 Tetorit të vitit 1985, pra 77 vjetorin e ditëlindjes së Enver Hoxhës. Më 15 – 16 Tetor të këtij viti me inisiativën e nën kujdesia e KQ të Partisë u organizua një konferencë kombëtare kushtuar Enver Hoxhës, ku merr pjesë e gjithë Byroja Politike dhe kuadro drejtuese partie e pushteti nga e gjithë Shqipëria. Për dy ditë me radhë u lexuan dhjetë referate. Por as në fjalën e Ramiz Alisë, as në referatin kryesor të Foto Çamit e në gjithë referatet e tjera **emri i Stalinit, për të cilin Enver Hoxha kishte folur aq shumë në veprën e tij prej revolucionari e i kishte kushtuar dhe libër të veçantë, nuk zihej me gojë qoftë dhe shkarazi për kortezi**.

Ishte kjo një harresë? Jo, Stalini nuk mund ta harronin të gjithë, aq më tepër që referuesit nuk qenë hamej të komunales, por anëtarë të Byrosë Politike e të Komitetit Qendror. Pra, nuk ishte një harresë, por ishte një kthesë, ishte një vijë e re, padyshim revizioniste. Referatet u botuan nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste me rreth 200 faqe libër në një tirazh të madh e që u shpërndanë në Parti e në popull. Ishte ky kalim dhelparak në revizionizëm, ishte kjo tragjedi, që për ironi të fatit dha sinjal në ditëlindjen e Enver Hoxhës, ishte ky devijim nga mësimet e Enver Hoxhës, që do ta çonin popullin e Partinë gradualisht në greminë. Kështu rodhën punët. **Në mëngjes** Partia i ktheu shpinën Stalinit, **në drekë** u hoqën nga librat shkollorë temat kundër revizionizmit dhe **në perëndim të diellit** u praktikuan mbledhjet e hapura të Partisë, ku mund të hynte derri e dosa, engjëlli dhe xhelati, **si dhe u prit në audiencën e Komitetit Qendror një nga fantazmet më të zeza e më të urryera të shekullit, agjenti plak i CIA-s, shkëlqesia e tij Sulzberger**, të cilin “Zëri i Popullit” na e shiti si “gazetar i mirënjohur”, kryeredaktori i së cilës veç Teserës së Partisë dhe mandatit të anëtarit të Komitetit Qendror, s’kish asgjë tjetër me vlerë, as talent si gazetar, as karakter si njeri, as besë si malësor. Kundërrevolucionarë që s’kishin lexuar hdoshta me vite të tëra gazetë, tani u bënë lexuesit më të zellshëm të “Zëri i Popullit”. Ky ishte revizionizmi. Kjo ishte tradhëtia.

Udhëheqja e Partisë mendoi se do të mbijetonte me revizionizëm. Por nëse Enver Hoxha mbijetoi pa revizionizëm 50 vjet, ata që mbetën pas s’do të mbijetonin me revizionizëm as pesë vjet. Nuk mbijetuan as pesë vjet sepse tradhëtuan për ç’kish

thënë e shkruar Enveri për 50 vjet. **Partia e humbi vigjilencën dhe kjo humbje vigjience provoi fjalët e Enverit se s'do të mund të kish më as parti as socializëm.** Koha tashmë e ka provuar saktësinë e këtij mësimi. Ja përse populli e historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha ishte një **internacionalist i madh**, mik i popujve, vëlla i komunistëve marksistë-leninistë kudo në botë. Në orët më të vështira për Atdheun tonë Enver Hoxha pati guximin e madh të hapë të gjitha portet e portat për të ndihmuar Partinë Komuniste Greke e Ushtrinë Demokratike Greke gjatë luftës civile, që konkretizohej në furnizimin me armë, në ngritjen e spitaleve fushore në thellësi të tokës sonë për të plagosurit që kthehesin përsëri në front etj. Anglo-amerikanët planifikuan ta përdorin si sebeb ndihmën ndaj Partisë Komuniste Greke dhe të **ndërhynin ushtarakisht** në Shqipëri. Enver Hoxha përsëri nuk u thye dhe u hapi udhë komunistëve dhe demokratëve grekë të kalonin nëpër Shqipëri pas disfatës. Ai ishte i pari udhëheqës komunist që dënoi vrasjen e **Niko Bellojanasit** e bashkëshortes së tij **Eli Joanidhi**, që i propozoi Kongresit të ngrihej në këmbë e të mbante zi për humbjen e Niko Bellojanasit dhe kampin më të madh të punëtorëve e pagëzoi me emrin e këtij biri të madh e të lavdishëm të popullit grek, i njohur si **njeriu me karafil**. Në librin **“Dy popuj miq”** Enver Hoxha ka shprehur ndjenjat më të sinqerta për popullin grek e komunistët grekë, veçanërisht për **kapedan Aris Veliqotis** e shumë komunistë të tjerë që emigruan në vendet e lindjes, me të cilët mbante korrespondencë.

Enver Hoxha i ka mbëstetur botërisht partitë marksiste-leniniste, atë gjermane me **Ernest Austin** në krye, atë spanjolle me **Raul Markon** në krye, ato të Australisë, Belgjikës, Kanadasë, Kongos, Ekuadorit, Portugalisë, Danimarkës, Ceilonit, Italisë, Meksikës, Kilit e të tjera, duke i ndihmuar me këshilla e ide po edhe materialisht. Mjaft anëtarë të rinj në radhët e tyre kanë studiuar sipas parimeve internacionaliste dhe në universitetet e shkollat tona ushtarake, përfshi dhe kongolezin Kabila. Enver Hoxha, ndërsa priste e përcillte si shokë idealesh në zyrën e tij një revolucionar vietnamez apo kongolez, një marksist-leninist të mrekullueshëm si **Ubaldo Butofava** e dhjetra të tjerë nga të gjitha kontinentet, nuk ia arriti të kish kontakt me komunistët heroikë të Turqisë, Partia e të cilëve u riorganizua vonë, pas lëvizjes studentore me Heronjtë e saj të famshëm **Deniz Gezmish, Hysein Inan e Jusuf Asllan**, por komunistët turq e Partia e tyre e ka vlerësuar si asnjë tjetër parti komuniste në botë veprën e Enver Hoxhës. **Impresionues e i pashlyer në kujtesë mbetet qëndrimi i komunistëve turq të burgosur kur morën lajmin se Enver Hoxha kishte vdekur. Në shejë dhimbjeje e sfide ata shpallën grevë urie.** Partia Komuniste e Shqipërisë merr guximin që t'i falenderojë vëllezerit komunistë të Turqisë në emër të Enver Hoxhës në 100 vjetorin e ditëlindjes së tij.

Enver Hoxhën e lidhte një miqësi e ngushtë me kryetarin e Partisë Komuniste të Brazilit, **Zhoa Amazonasin**, siç e lidhte një miqësi e ngushtë edhe me antifashistin e njohur grek **Manolis Glezos**, i vetmi personalitetit i huaj që mori pjesë në ceremoninë e varrimit të Enver Hoxhës. Me çdo parti komuniste marksiste-leniniste e udhëqës të tyre sillej si shok e vëlla idealesh dhe bisedonte me ta nga pozitat e të barabartëve. I thjeshtë e largpamës Enver Hoxha nuk pranoi krijimin e një **Internacionaleje të Re Komuniste** me qendër Tiranën dhe nuk u mbajt asnjëherë para shokëve të partive të tjera si një udhëheqës i një parti mëmë, por vetëm si udhëheqës i një partie motër. Enver Hoxha mbështeti botërisht luftën e drejt të **popullit korean** në vitët 50-të, përshëndeti **revolucionin kuban të Fidel Kastros dhe Ernesto Çe Guevarës**, ishte solidar me luftën e **popullit palestinez e vietnamez** dhe çdo luftë të drejtë të popujve të tjerë. Si antiimperialist e antisocialimperialist i madh dënoi pushtimin e Çekosllovakisë dhe çdo pushtim tjetër nga ana e dy superfuqive, të cilat i shpalli para

botës njësoj të rrezikshme. Me shënimet dhe reflektimet për çdo trazirë në botë, në Lindjen e Mesme, Afrikë apo Amerikën Latine, Enver Hoxha i la një emër të mirë vetes dhe në mendjet dhe zemrat e komunistëve dhe demokratëve përparimtarë revolucionarë në gjithë botën. Ja përse populli dhe historia i janë mirënjohës Enver Hoxhës.

Enver Hoxha luftoi e punoi si askush tjetër në interes të Atdheut e kombit shqiptar. Pas triumfit të kundërrevolucionit, armiqtë e kombit shkatërruan industrinë shumëdegëshe të ngritur me mund e me djersë në rreth 50 vjet dhe në vend të saj ngritën industrinë e antikomunizmit. Ndër fjalët e para që thanë ishin: “Enver Hoxha ka tradhëtuar çështjen kombëtar, ka shitur Kosovën”.

Jo njëherë armiqtë e kombit shqiptar janë përpjekur të mbulonjë fytyrën e tyre antikombëtare pikërisht duke u paraqitur me maskë kombëtare, madje duke arritur deri atje sa të vetëshpallen Balli Kombëtar, por historia i njohu si Turpi Kombëtar. **Ishte Enver Hoxha ai që shpëtoi ekzistencën e kombit dhe u përpoq që ky komb të konsolidohej.** Ashtu si i mbyturi kërkon të mbahet prej flokëve të tij, ashtu dhe të vetëquajturit nacionalistë të Ballit kërkojnë të kapen sot pas Mukjes, pranë varrit dhe turpit të së cilës shkojnë e falen si në Mekë.

Është provuar e stërprovuar se këta nacionalistë tradhëtarë s’kishin aspak as hallin e çlirimit të Atdheut e as të Shqipërisë etnike, por hallin e sundimit të tyre. Marrëveshja për “**Komitetin e shpëtimit kombëtar**” që doli më 1943 nga Mukja ishte në realitet marrëveshje për “**Komitetin e minimit kombëtar**”, marrëveshje që, po të mos ishte hedhur poshtë, do të krijonte një konfuzion katastrofik në Shqipëri në një kohë kur kishte një Front dhe një Shtab të Përgjithshëm të Ushtrisë. Megjithë dëshirën e mirë të PKSH dhe Enver Hoxhës që ballistët të hidheshin në luftën e popullit më fort i bashkuar të vriste fashizmin, nacionalistët tradhëtarë të Ballit Kombëtar e vranë Mukjen me qëllimin e vetëm të vrisnin të ardhmen e popullit dhe të siguronin vetëm të ardhmen e tyre. Enver Hoxhës nuk i mbeti gjë tjetër vetëm se të urdhëronte të varrosej kufoma e Mukjes që të mos qelbej ajri. Marrëveshjen e saj e flaku në zjarr që të mos digjej kombi në zjarr.

Ndërsa Enver Hoxha nga ana e tij hidhte divizionet partizane në tokat shqiptare në Jugosllavi me qëllimin e shenjtë që shqiptarët e atjeshëm të luftonin fashizmin, ndryshe nesër pas luftës do të konsideroheshin profashistë e serbët do ta përdornin këtë fakt si kryqin e shenjtë për t’i zhdukur kosovarët nga faqja e dheut të kombit, ndërsa divizionet e Enver Hoxhës derdhin gjakun për Kosovën e krejt popullin shqiptar të mbetur nën Jugosllavi, “etnikët” nacionalistë të Ballit Kombëtar luftonin krah për krah gjermanëve kundër Shqipërisë e uronin fitoren e armiqve të mbarë njerëzimit.

Është e dokumentuar se pas çlirimit Enver Hoxha kërkoi pranë Titos bashkimin e Kosovës dhe tokave të tjera shqiptare me Shqipërinë. Titua, që kishte plane të tjera ndaj Shqipërisë nga njëra anë dhe frikën e serbëve nga ana tjetër, e zvarriti problemin dhe nuk e mbajti fjalën që kish dhënë më parë se do të udhëhiqej nga parimi universal i vetëvendosjes. Por, për hir të realitetit, Titos nuk mund t’i mohohet një gjë gjithësi jo e parëndësishme. Jepi Çezarit atë çka i përket Çezarit, ose, siç thotë populli ynë edhe hasmit jepi hakun. Josip Broz Tito **e pranoi që Kosova dhe tokat e tjera në Maqedoni e Mal të Zi ishin toka shqiptare e duhej t’i bashkoheshin Shqipërisë.** Kjo pasqyrohet edhe në arkivat ruse.

Ndërsa në fillim të viteve 90-të “nacionalistët” shqiptarë shpifnin e u shërbenin serbëve për inat të Enver Hoxhës e komunizmit, nga arkivat ruse doli një **dokument historik**, çuditërisht i panjohur: Leter voluminoze që Enver Hoxha i drejtonte Stalinit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ku kërkonte të niste lufta e armatosur për

të përmbysur klikën Titiste dhe tokat shqiptare në Mal të Zi, Kosovë e Maqedoni t'i ktheheshin Shqipërisë, shqiptarët të luftonin nën flamurin shqiptar e nën komandën e shqiptarëve dhe t'u sigurohej bashkimi me Shqipërinë qysh në fillim të luftës. Kurrëfarë zgjidhje tjetër, vijonte Enveri, popullsia e Kosovës nuk dëshiron ta pranojë, çdo zgjidhje tjetër ajo e quan të padrejtë, të padrejtë e quajmë atë edhe ne.

Për çështjen në fjalë u prononcua edhe një historiane ruse, Nina Smirnova, e cila, edhe pse nuk e fsheh se s'ka simpati për të ashtuquajturin stalinizëm të Enver Hoxhës, rrebelohet megjithatë të mbrojë të vërtetën rreth Enver Hoxhës. Ja deklarata e Nina Smirnovës: **"Nuk e kuptoj se përse disa politikanë e studiues në Shqipëri e sulmojnë aq shumë Enver Hoxhën për qëndrimin e tij ndaj Kosovës. Këta, qofshin profesorë a çfarëdo qofshin në Shqipëri, janë sharlatanë në shkencë dhe sahanlëpirës në politikë. Enver Hoxha ka qenë komunist nacionalist që për hir të Kosovës ishte gati t'i vinte flakën Jugosllavisë e më gjerë. Letra e tij drejtuar Stalinit në vitin 1949 është dëshmia më e qartë për qëndrimin e tij ndaj Kosovës. Por ka edhe materiale të tjera të pabotuara që e vërtetojnë më së miri këtë".** Këtu duke respektuar të vërtetën historike që pohon Smirnova, është vendi të theksohet si i papranueshëm etikimi "komunist nacionalist". Edhe shumë studiues e politikanë të huaj e cilësojnë Enver Hoxhën **"komunist nacionalist"**. Enver Hoxha ishte një patriot e luftëtar i Atdheut e kombit, komunist marksist-leninist dhe internacionalist.

Ndërsa në Tiranë reaksioni shqiptar mallkonte me shpifje Enver Hoxhën si armik të Kosovës e mik të Jugosllavisë, në Moskë Enver Hoxha mallkohej në drejtim të kundërt, si armik i Jugosllavisë dhe njeriu që i mbushi mendjen Stalinit që Bashkimi Sovjetik të prishej me Jugosllavinë e që Enver Hoxha të fitonte Kosovën. Historiana Nina Smirnova deklaroi: **"Sot, te ne në Rusi, Enver Hoxha kritikohet kaq shumë pikërisht për nacionalizmin e tij e madje, këtu në Rusi, arrijnë deri atje sa ta cilësojnë atë si shkatarin kryesor të prishjes së marrëdhënieve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë e kjo, kryesisht, për ambicjet e tij për Kosovën e tokat të tjera shqiptare në Jugosllavinë e asaj kohe"**.

Enver Hoxha dhe Shqipëria socialiste sakrifikuan e bënë aq sa mundën në rrethanat e kohës për Kosovën e çështjen kombëtare. Enver Hoxha e kaloi ushtrinë në veri në orë të vështira për Kosovën që të ndërhynte me forcë nesë ngjarjet do të perceptonin ku s'mban më, madje tashmë ish ushtarakët e lartë kanë treguar edhe për plane e harta lufte për çlirimin e tokave shqiptare në Mal të Zi, Kosovë e Maqedoni. Zërin dhe presionin e Enver Hoxhës për të drejtat e shqiptarëve në trojet e tyre në Jugosllavi dhe ndonjë rrezik të mundshëm e pati ndjerë edhe Titua, që nuk ishte një budalla si Millosheviçi, prandaj bëri ç'bëri, e shpalli Kosovën krahinë autonome dhe kosovarët i gëzuan sidoqoftë disa të drejta. **Enver Hoxha e shpalli para gjithë botës Shqipërinë si një komb prej 6 – 7 milionësh dhe ngjarjet me rëndësi kombëtare nuk i pa të ndara, po si një komb, siç është Kongresi i Njësimit të Gjuhës Shqipe, ku vendimet e tij historike i morën sëbashku shqiptarë të Tiranës e shqiptarë të Prishtinës.**

Reaksioni antikomunist i djeshëm dhe i sotëm e harrojnë ose u pëlqen të harrojnë se Enver Hoxha kur fliste për Kosovën **kishte parasysh gjithë tokat shqiptare nën Jugosllavi**. Lidershipi kosovar bëri të kundërtën. Lidershipi shqiptar as sot e kësaj dite nuk guxon ta thotë këtë. Kush pra e tradhëtoi kombin, Enver Hoxha apo armiqtë e Enver Hoxhës? **Enver Hoxha deklaronte se Kosova është Shqipëri**. Lidershipi i sotëm i Tiranës dhe Prishtinës nuk guxojnë ta thonë këtë dhe i këndojnë me çifteli Ahtisarit i cili për hir të realitetit si politikan i lartësive të admirueshme bëri diçka të admirueshme për Kosovën, por jo plotësisht të lavdërueshme e të pranueshme.

Kush pra e ka tradhëtuar kombin, Enver Hoxha apo armiqtë e tij? Enver Hoxha e shihte të ardhmen e kombit e të Kosovës si degë e tij, siç e kishin parë Isa Boletini e Bajram Curri. Lidershipi shqiptar i ditëve tona nuk e shikon kështu. Kush pra e ka tradhëtuar kombin, Isa Boletini, Bajram Curri e Enver Hoxha, apo ata që dridhen e përdridhen si qengj e kërcejnë sipas muzikës së integritimit copa-copa në Evropë?

Enver Hoxha duket qartë në të gjithë veprën e tij se priti një shans historik për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Kur ky shans erdhi në prag të viteve 90 Enver Hoxha nuk ishte më gjallë dhe Kosova u la mënjanë nga udhëheqja e Shqipërisë, si dhe u **tradhëtua** nga vetë udhëheqësit kosovarë të kohës. Ndërsa ish republikat e Jugosllavisë i shpallën luftë Serbisë dhe dolën një nga një më vete, lidershipi kosovar ziente hallvë në Prishtinë dhe reaksioni shqiptar, në unison me atë kosovarë, në vend që t'i shpallin luftë Serbisë, i shpallën luftë Enver Hoxhës e Shqipërisë, duke i ardhur direkt apo indirekt në ndihmë Serbisë.

Disa gazetarë të poshtër kosovarë, bij të adoptuar të kriminelit Millosheviç, si një farë Buton serb, që bën haxhillëk në Beograd e derdh vrer kundër Enver Hoxhës në gazetatat e ndyra të Prishtinës e Tiranës, kujtojnë se mund të errësojnë dritën e një gjeniu kombëtar dhe helmojnë me poshtërsitë e tyre shpirtin fisnik të popullit të Kosovës. I gënjen mendja. Respektin e kanë shprehur me pikëllim qiellor kosovarët në **Manifestin e Dhimbjes** kur vdiq Enver Hoxha. Këtij manifesti tronditës nuk i dihet autori, që ka mbetur anonim, por i dihet shpirti e ky shpirt është ai i Kosovës. Respektin për Enver Hoxhën e shprehu populli i Kosovës edhe më 10 Tetor në mitingun e madh në sallën e kuqe të pallatit të rinisë dhe sporteve në fjalën e njërit prej bijve më të lavdishëm të Kosovës Hydajet Hysenit, apo më 11 Tetor në mitingun e Ferizajt. Disa individë të veçuar që lehin rrugëve për honorare janë bij shqiptarësh por pa gjak shqiptari. Po të kishin gjak shqiptari le të shkonin në batalionet e nderit që derdhin gjak për çlirimin e Kosovës.

Kur bijtë dhe bijat e Adem Jasharit, këtij vigani të Lirisë, derdhin gjak për çlirimit e Kosovës nuk ishte Enver Hoxha që u ngrit nga varri e i shkoi Bill Klintonit në Amerikë t'i thotë: "**Zoti Klinton, ushtarët e çlirimit të Kosovës janë enveristë, marksistë-leninistë, stalinistë, maocedunistë**". Se kush i tha këto fjalë antiliri e di historia. Kur derdhej gjak në Kosovë nuk ishte Enver Hoxha që furnizonte Serbinë me naftë. Se kush e bënte këtë furnizim antikomb e antiKosovë që nga Shqipëria e di historia.

Kur plasi lufta në Kosovë asnjë parti politike në Shqipëri nuk e mbështeti atë përveç PKSH që udhëhiqej nga mësimet e Enver Hoxhës, e cila, edhe pse ishte në ilegalitet, bëri sa mundi me shtypin e saj ilegal qysh në krismat e para. Komandanti legjendar Adem Jashari arrestohej në Shqipëri, sepse ky hero i madh i bënte hie mbretit të Kosovës. Ndërsa intelektual legjendar Ukshin Hoti mbytej nga UDB-ja serbe e sot s'i dihet as varri, njëri prej veprimtarëve të shquar për lirinë e Kosovës, Remzi Hoxha, u mbyt në tortura nga SHIKU-u shqiptar dhe sot nuk i dihet as varri. Demokratë e socialistë fillimisht usharët e çlirimit të Kosovës i cilësuan terroristë dhe shtypi Partisë Demokratike i bënte thirrje UÇK-së të mos çlironte Kosovën nga serbët gjaktarë, po Shqipërinë nga socialistët. UÇK-ja luftoi dhe historia e saj u mbulua me lavdi, por një popull kosovar i përçarë dhe një komb i përçarë e i çoroditur nuk e mbështeti atë luftë në shkallën e duhur. Kjo është kështu dhe jo ndryshe. Vetëm kur në çështjen tonë kombëtare u angazhua Amerika forcat politike në Shqipëri e hodhën hapin sipas muzikës amerikane. Serbët megjithatë e dinin se Enver Hoxha nuk rron më fizikisht dhe se Ushtria e pamposhtur e Enver Hoxhës kishte vdekur, prandaj me lehtësinë më të madhe goditën e minuan kufirin shqiptar, duke i lënë fshatarët e atyre zonave pa këmbë.

Gjithë jeta e vepra e Enver Hoxhës flasin për një patriot të madh. Askush më shumë se ai s'ë ka vlerësuar historinë e kombit shqiptar, çdo përpjekje për liri e pavarësi, çdo lëvizje me karakter popullor, qoftë dhe lëvizjen fshatere të Haxhi Qamilit, të cilën e vlerësoi aq sa duhej vlerësuar, me anët pozitive dhe negative që ai pati. Fshatari kryengritës Haxhi Qamili nuk qe një hero i përsosur, megjithatë disa kryministra e ministra që kanë udhëhequr vendin nga vitet nëntëdhjetë e këtej nuk kanë as vlerën e opingave dhe të brekusheve të Haxhi Qamilit.

Enver Hoxha sa qe gjallë e ngriti historinë kombit dhe të heronjve të tij të shquar në monumente bronxi që të krenoheshin brezat e ardhshëm, ndërsa ata që erdhën pas tij ngritën vetëm disa mullarë turpi me kashtë të qelbur, para të cilëve brezat që vinë do të ulin kryet të turpëruar e do të mallkojnë arkitektët e turpit. Nëse flasim për historinë e nderit të kombit do të ishim të vërtetë kur atë ta gjykonim pazgjydhmërisht edhe me emrin Enver Hoxhës. Kombi dhe Enver Hoxha janë një e të pandarë. Por tradhëtarët e kombit tonë do të ishin gati që kombi ynë të shpërbëhej e të shkrihej si kripa në det mafton që të errësohej e të kriminalizohej figura e Enver Hoxhës. Një eufori e madhe ka pushtuar lidshpin shqiptar të ditëve tona për arritjet kombëtare, që na qenkan realizuar. Pavarësia e Kosovës është padyshim një fitore shumë e madhe dhe kjo i detyrohet luftëtarëve heroikë të UÇK-së. Por nuk i kemi arritur qiejtë. Kombi shqiptar në pesë republika shtetesh ishte e në pesë ka mbetur. Jo vetëm kaq. Po të kemi parasysh edhe "Republikën e Lazaratit" dhe "Republikën e Himarës", të këtyre dy shteteve brenda shtetit, na dalin shtatë. Sot në Shqipëri një gangster serbo-boshnjak, një farë Fazlliçi, i lidhur me klanet më të zeza të Millosheviçit, gjen parajsën në Shqipëri, siguron toka e firma të dyshimta, madje merr pjesë deri në mbledhjen e Sigurimit Kombëtar, skandal ky i paprecedent në histori. Sot në Shqipëri një kryebandit kryetar i një bashkie të vogël në vetë shteti dhe tallet me integritetin tokësor të Atdheut e me nderin e kombit. Në kohën e Enver Hoxhës s'guxonte bandit të tallej me integritetin e Shqipërisë e nderin e kombit. Ja përse populli dhe historia do t'i jenë mirënjohës Enver Hoxhës.

Shokë dhe shoqe,

100 vjetorin e lindjes së Enver Hoxhës nuk po e nderojmë thjeshtë si historianë, politologë, sociologë, studiues, monografë e bibliografë, por si një forcë politike, si Parti Komuniste. Si e tillë detyra e saj nuk merr fund për çfarë kemi thënë e thamë lidhur me vlerësimin e veprës shumë dimensionale të Enver Hoxhës. Ajo ka një detyrë shumë më të madhe përpara e natyrisht shumë më të vështirë, e cila kërkon jo vetëm sakrificë mbinjerëzore, por edhe vetmohimin, edhe jetën. Detyra kryesore e Partisë Komuniste aktualisht është:

1. Enver Hoxha ka lënë një vepër. Lutjet e uratat mbi të s'kanë vlerë po nuk u përdor ajo si udhëheqje për veprim. Ne jemi të kthjellët në vorbullat e stuhive mafioze që krijojnë reaksioni dhe socialdemokracia me mullinj të tyre. Reaksioni e konsideron veprën e tij të gabuar. Nuk çuditemi. Por ka edhe ndër ata që pyesin: "**Kishte a s'kishte gabime Enveri, përse ju komunistët nuk evidentoni edhe gabimet?**" Por edhe ne kemi të drejtën të shtrojmë pyetjen: Lexohet në veprën e tij ndonjë orientim i gabuar, ndonjë këshillë e gabuar, ndonjë ide e gabuar? Nuk rezulton asgjë e gabuar në veprën e tij e normalisht ne s'keni të drejtë të fantazojmë gabime. Po a ka patur gabime në socializëm, a ka patur edhe padrejtësi, të meta e dobësi? Vetëm të çmendurit mund të thonë se s'ka patur, sidomos në vitet 80-të, ku padyshim disa masa krejt të parakohëshme e të pabazuara në realitetin e çuan vendin në krizë. Të mos harrojmë se në socializëm ka patur edhe

veprimtari armiqësore, edhe burokratizëm, edhe servilizëm, edhe karrierizëm, edhe sekularizëm, edhe injorantë në refrenin e tyre të shëmtuar:”**E di Partia**”. Gjëra të tilla ka patur edhe në Rusi në kohën e Leninit, po ato s’mund t’i faturohen Leninit, kur Lenini e ka të pastër veprën e tij dhe ishte kundër tyre. E njëta gjë nënkuptohet për Enverin. **Asnjë konçension e lëshim pragmatist nuk i bëjmë reaksionit antikomunist në këtë pikë.**

Stalini është shprehur në kohën e tij se edhe fitimarët mund dhe duhet të gjykoen. Kjo është një tezë e drejtë. Epoka e Enver Hoxhës epokë fitimtarësh ishte, por kjo s’na heq të drejtën të gjykojmë me drejtësi për çfarë u bë e nuk u bë mirë, sepse edhe vetë rendi socialist nuk presupozohet i përsosur. Por s’kemi asgjë të gjykojmë veprën e një udhëheqësi për disa gabime në jetën praktike që kanë qenë të dënueshme po në veprën e këtij udhëheqësi. Mësimet e Enver Hoxhës nuk janë gabimi, por antigabimi. Prandaj çdo komunist, çdo militant, e gjithë Partia duhet të pyes në këtë 100 vjetor vetveten: Jemi Parti Komuniste Revolucionare, apo parti lulishte që di vetëm të mbjellë mbi pllaka çimentoje sallash lule fjalësh, ndërsa barrikatat jashtë janë bosh? Ne jemi Parti Komuniste, jo parti lulesh, por nuk jemi të imunizuar edhe nga “sëmundja e luleve”. Sot është dita dhe ora më e shenjtë të ndahemi njëherë e përgjithmonë nga kjo sëmundje, të gjejmë rrugët për t’u lidhur më shumë me masat popullore, të përsosim taktikën dhe strategjinë tonë dhe me flamurin e Enver Hoxhës të hidhemi me vepra në barrikadë e të luftojmë me shpirt të palëkundur besimi e vetmohimi në forcën tonë dhe në triumfin e kauzës tonë.

2. Kanë kaluar më shumë se dyqind vjet nga ora kur demokrati i madh revolucionar Maksimilian Robespieri tha në klubin e jakobinëve:”**Në Francë ka vetëm dy parti: Populli dhe armiqtë e tij**”. Po mbushen gati 20 vjet që në Shqipëri fitoi kundërrevolucioni. Këta rreth 20 vjet s’kanë qenë pak që Partia Komuniste të paktën të kuptonte me bindje absolute se sot **në Shqipëri ka vetëm dy parti: Populli dhe armiqtë e tij**. Duke e konsideruar veten bij të popullit, repart pararojë të klasës, ne duhet të shkundemi deri ne gjak, deri në kockë nga çdo iluzion se ky armik është i zi e ky tjetri më pak i zi. Të gjithë armiqtë e popullit kanë një shpirt e një fytyrë, të cilët në njëren dorë mbajnë kazmën e në tjetrën lopatën për të gërmuar e mbuluar varrin e popullit dhe të mbretërojnë të qetë mbi të. Ne hapur e me bindje absolute duhet ta denoncojmë më me shumë forcë para popullit e historisë këtë skenë makabre. Po nuk bëmë këtë, ose do të shkojmë në gijotinë si Robespieri, ose, më keq akoma, Partia Komuniste do të vdesë gradualisht nën këmbët e borgjezisë e të armiqve të popullit dhe askush s’do të lajmërojë vdekjen e saj qoftë dhe me ndonjë afishe në ndonjë faqe shtylle apo faqe muri. Një vdekje e tillë do të ishte tradhëti e lartë ndaj popullit e Atdheut. Jeta e vepra e Enver Hoxhës na bën sot, në këtë orë, apel të dalim para kohës e t’i prijme kohës me Manifestin e kohës.
3. Është shumë e vërtetë se sot në Shqipëri fytyra xhelate e antikomunizmit është më e zezë se në çdo vend tjetër të Evropës. Është shumë e vërtetë se Partia Komuniste është vënë në darën e bllokadës edhe nga i gjithë reaksioni djathtist e socialdemokrat. Është shumë e vërtetë se tashmë ish komunistët e kthyer në kapitalistë e apologjetë të kapitalizmit që veprojnë në Partinë Socialiste e të tjera si ajo na urrejnë e përçmojnë, ndoshta aq sa reaksionarët e vjetër, në mos më shumë. Është shumë e vërtetë se ish elita komuniste e

Partisë së Punës dhe bijtë e kësaj elite as janë kujtuar e as mos prisni të kujtohen ndonjëherë për Partinë Komuniste. Ajo e tradhëtoi popullin dhe Enver Hoxhën, socializmin e komunizmin dhe s'mund të presim tjetër prej saj veç plumba ballit po t'i rrezikohet fronti i kimit ku tashmë është ngjitur. Kasta e ish Komitetit Qendror të Partisë së Punës nuk ia ka falur kurrë Partisë Komuniste denoncimin që i ka bërë si kastë tradhëtare, prandaj segmente të kësaj kaste kanë bërë ç'është e mundur për ta përçarë Partinë Komuniste e mundësisht për ta eliminuar atë, që një parti tjetër në vend të saj të dalë me minifund në koncertin e politikës e të këndojë refrenin:”**Edhe Skënderbeu ka qenë i mirë, por edhe tradhëtari Hamza Kastrioti ka qenë i mirë**”. Është shumë e vërtetë se përballë popullit e Partisë Komuniste ndodhet jo vetëm partia e bashkuar e armiqve të popullit, por edhe një pjesë e madhe e popullit, për të mos thënë shumica dërmuese e tij, që si rezultat i mashtrimit prej armiqve të tij është kthyer armike e vetvetes. Po, këto janë të vërteta. Por këto për një Parti Komuniste s'duhet të përbëjnë arsye që ajo të humbas besimin në të ardhmen e saj e të thyhet para vështirësive. Këto vështirësi Enveri i dinte dhe kur ishte në pushtet. Por ai, nuk ishte pesimist, përkundrazi theksonte se:”**Epoka e revolucioneve proletare sapo ka filluar. Ardhja e socializmit përfaqëson një domosdoshmëri historike që rreth nga zhvillimi objektiv i shoqërisë. Kjo është e pashmangshme. Kundërrevolucionet që janë bërë, pengesat që dalin mund t'i zgjat edhe ca jetën sistemit të vjetër shfrytëzues, por ata janë të pafuqishme për të nadaluar marshimin e shoqërisë njerëzore drejt të ardhmes së saj socialiste**”. Le të mos harrojmë këtë mësim.

4. Le të mos thyhemi e dekurajohemi as nga pazaret që bëjnë me njëra-tjetrën PD e PS. Pazari i 21 Prillit për të realizuar ëndrrën e çmëndur për pushtet të një njeriu e të një kaste, për të zhdukur çdo parti tjetër, rikheu në fuqi kushtetutën reaksionare antipopullore që më 1994 e hodhi poshtë populli. Partia Socialiste me turp e vetvrasje e nisi jetën 17 vjet më parë dhe me turp e vetvrasje do ta bitisë. Kryetari i sotëm i saj, i rreshtuar 17 vjet më parë në falangat më të zëza fashiste, thërristë:”**Komunistët në litar, veteranët në hanxhar**”. Ky ia mbërriti ditës të bëhet bash kryetari i Partisë së veteranëve dhe ish komunistëve. Dhe po e mban fjalën. Me teorinë e tij “**përtej të majtës e të djathës**”, që kurrë nuk e ka spjeguar se ç'do të thotë, e ka vënë këtë parti tashme kufomë në teh të hanxharit e në lak të litarit. Kështu kjo parti e tradhëtisë dhe e turpit e ka fundin në varrin e ish anëtarit të saj të nderit Benito Kraksit. Kjo thjeshtë sepse ajo u nda nga nëna që e lindi e populli që e rriti. Partia jonë mund të duket e vogël sot, por ka perspektivën të jetë Ante nesër, sepse i ka rrënjët në popull, prandaj do të jetë e fortë siç ishte i fortë Anteu përse nuk shkëputej nga toka. Le të mos i harrojmë edhe ato fjalët e Roza Luksemburgut 94 vjet më parë, që i përmend Stalini në veprën e tij, se socialdemokracia është një kofumë i qelbur. Kësaj kofume ia ka përcaktuar rreziqet qindra herë Enver Hoxha në veprën e tij. Dy rrugë ka: O me Enver Hoxhën në luftë praktike, o me socialdemokracinë e tradhëtinë e saj.
5. Bota s'do të jetë kështu si është. Të tjera erëra po fryjnë e do të fryjnë në këtë botë imperialiste e kapitaliste në krizë. Xhon Ridi dikur ditët e Revolucionit të Tetorit i paraqiti në librin “**10 ditët që tronditën botën**”. Vetëm një muaj më parë e tërë bota u trondit nga kriza e superfuqisë më të madhe financiare, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo krizë po ndihet edhe në Gjermani e

Angli. Si pasojë e krizës vetëm në një ditë, të quajtur “**E Hëna e zezë**” tronditet bursa evropiane e humbet 480 milionë dollarë. Krizat vetëm do të kthjellohen për të gjetur udhën e tyre të shpëtimit. Sot ka jo pak njerëz të cilët urtësinë e besimit të komunistëve në të ardhmen e popujve e quajnë çmenduri. E kjo ndodh sepse ata janë të verbër e mbahen fort pas modelit të marrëzisë së tyre. E kjo na kujton fjalët e një gjeniu të njerëzimit të quajtur Gëte:”**Atje ku marrëzia është model, urtësia është çmenduri**”. Të çmendurit nuk mund ti ndalojnë përjetësisht ligjësitë historike të kalimit nga një sistem në tjetrin. Të çmendurit nuk mund të ndalojnë dritën e mësimeve të Enver Hoxhës të ndriçojë. Sot kapitalizmi nuk është në kulmin e forcës dhe lulëzimit të tij, por në kulmin e krizës dhe shkatërrimit të tij. Kapitalizmi ndodhet drejt fundit të tij të pashmangshëm. Ne të urtit e dimë këtë dhe ecim kryelartë e të pamposhtur me besimin e plotë se nesërmja e botës është komunizmi.

Ne komunistët jemi bij dhe bija të Enver Hoxhës, anëtarë të një Partie që ka udhëhequr dikur me lavdi Enver Hoxha, prandaj jemi e do të jemi krenarë në udhën tonë të mundimshme. **Toka shqiptare dhe Nëna shqiptare nuk kanë lindur e krijuar asgjë më të lartë e më të bukur, asgjë më njerëzore e të mahnitshme, asgjë më të drejtë e të ndershme, asgjë më të urtë e krenare, asgjë më të zjarrtë e frymëzuese se sa Enver Hoxhën.** Sot Shqipëria është shumë e varfër në kuptimin e shpirtit njerëzor, pa poetin e duhur që mund të shkruaj poemën e madhe të së vërtetës për njeriun me emrin Enver Hoxha, por kur ndoshta ne s’do të jemi gjallë, Toka shqiptare e Nëna shqiptare do ta linden e ta krijojnë këtë poet, i cili ndoshta do të gjykojë me urtësi se **hapësira e një Panteoni nuk e nxë Enver Hoxhën, ndërsa Enver Hoxha e nxë Panteonin.** Shpirti i këtij njeriu univeral ishte një Panteon i gjallë e i pakufi ku ndizej me madhësi të pashuar Dielli i dashurisë për Atdhe, ku pikonte si shi diellor malli për gurët e murmë të kalldrëmve të Gjirokastrës ku hodhi të parat hapa e loti i rëndë si plumbi për tokën e Kosovës 100 vjet të robëruar, ku zbardhë mëngjesi i kujtimit për shokët e rënë në betajat partizane prej tij të komanduara, ku jehonin gjëmimet e historisë e ngriheshin monumente Skënderbeu e Naim Frashëri, Isa Boletini e Bajram Curri, Çerçiz Topulli e Ali Kelmendi, ku ligjëronin si në një ditë pranvere bilbilat e malit e çelnin vrullshëm lulet e Çajupit, ku kishte strehimin e përjetshëm një popull i tërë me gëzimet dhe hallet e tij. Ky ishte Enver Hoxha, njeriu që përkulej e binte në gjunjë vetëm përpara Flamurit Kombëtar, martirëve të Atdheut dhe popullit, të cilën e deshi si askush tjetër. Enver Hoxha e bekoftë Shqipërinë!

Lavdi jetës dhe veprës së Enver Hoxhës!

Lavdi Marksizëm-Leninizmit!

Tiranë, 15 Tetor 2008